

# Termocentrali i Propozuar

## *Kosova e Re:*

### Një Barrë e Panevojshme me një Çmim të Paarsyeshëm

**Janar 2016**



**Institute for Energy Economics  
and Financial Analysis**  
IEEFA.org

**Nga Tom Sanzillo, Drejtor i Financave**

**David Schlissel, Drejtor për Analizë dhe Planifikim të Resurseve**

# Përmbledhje ekzekutive

Termocentrali i propozuar me djegie tërëgjilje "Kosova e Re" do të shkaktoj rritjen e çmimit të energjisë elektrike në Kosovë në nivele të paarsyeshme dhe do të bëhet një barrë e panevojshme afatgjate për ekonominë e Kosovës.

**IEEFA ka ardhur në përfundim se Banka Botërore, e cila e ka deklaruar mbështetjen e saj me një subvencion substancial financiar për ndërtimin e termocentralit me djegie të tërëgjiljeve, në vend të kësaj duhet të investoj në zhvillimin e energjisë së ripërtërishme dhe eficientës së energjisë në Kosovë. IEEFA konstaton se edhe qeveria e SHBA-së, e cila e ka mbështetur këtë projekt, duhet të ndërpres mbështetjen e saj për fillimin e gabuar të kësaj forme të kushtueshme dhe të vjetruar të gjenerimit të energjisë elektrike.**

Ky dokument analizon se si qytetarëve të Kosovës do t'u duhet të ri-alokojnë në mënyrë drastike buxhetet e familjeve të tyre për të paguar për *Termocentralin Kosova e Re* nëse ai ndërtohet. Ky ndikim nuk është adresuar më herët nga asnjë studim tjetër teknik, mjedisor, ekonomik ose financiar energjetik për termocentralin e propozuar.

Studimi i IEEFA-së po ashtu tregon se kostoja për prodhimin e energjisë nga *Termocentrali Kosova e Re* do të jetë katërfish me e lartë se kostoja aktuale e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Dhe për shkak se TC Kosova e Re do të jetë një shtesë joproportionalisht e madhe në sistemin relativisht të vogël të energjisë elektrike, ai do të ngris çmimin e energjisë elektrike për familjet kosovare. Hulumtimi i IEEFA-së tregon se *Termocentrali Kosova e Re* do të rris çmimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë për së paku 33.8 për qind e deri në 50 për qind.

Tarifat e energjisë elektrike në Kosovë edhe ashtu janë tepër të larta, veçanërisht për banorët që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Shumica e familjeve në Evropë paguajnë më pak se 6 për qind të të ardhurave të tyre vjetore për energji elektrike; në Kosovë kjo përqindje është dukshëm më e lartë.

*Termocentrali Kosova e Re* do të përkeqësojë gjendjen financiare të familjeve kosovare në të gjitha aspektet:

Nëse ndërtohet termocentrali:

- Familja mesatare do të paguaj 12.9 për qind të të ardhurave vjetore për energji elektrike.
- Familjet me të ardhura të ulëta deri mesatare do të paguajnë 18 për qind të të ardhurave të tyre për energji elektrike.
- Familjet me të ardhura shumë të ulëta, që jetojnë nën kufirin e varfërisë dhe që harxhojnë më pak energji elektrike se familjet e tjera, do të paguajnë 39.7 për qind më shumë për energjinë elektrike.

Termocentrali i propozuar bart në vete një numër të madh rreziqesh financiare për Kosovën. Sipas modelit aktual të propozuar të financimit, Qeveria e Kosovës duhet të marrë hua 945 milionë euro për të mbuluar 70 për qind të koston së projektit. Një zhvillues privat, me bazë në Nju Jork, ContourGlobal, i cili është ofertuesi i vetëm për këtë projekt, do të ofroj financim përmes ekuitetit për 30 për qind të koston së mbetur të projektit sipas një skeme e cila do të vjelë një

kthim prej më tepër se 20 për qind.

Ndër shenjat e rrezikut që sheh IEEFA në *Termocentralin* e propozuar Kosova e Re:

- Barra e propozuar e borxhit prej 945 milionë eurosh për një termocentral të vetëm me djegie thëngjilli në një vend sa është Kosova do të shkaktonte një trysni tepër të madhe në sistemin bankar të vendit dhe ka gjasa të lartë për investimet e reja në fushat e tjera të ekonomisë.
- Duke marrë në konsideratë projektin me një ofertë të vetme me kosto sa TC Kosova e Re, qeveria është duke rrezikuar kontrollin vendor të sistemit të saj të energjisë elektrike, qasjen në të hyrat e tij, vendimet themelore organizative siç janë për shembull punësimi apo largimi i punëtorëve dhe rritjen e tarifave në të ardhmen.
- Planet për termocentralin e ri janë bazuar në supozime optimiste për rritjen ekonomike. Nëse termocentrali funksionon nën kapacitetin e pritur sepse rritja ekonomike do të jetë më e ulët se që pritet, energjia elektrike do të bëhet edhe më e shtrenjtë.
- Termocentrali ka shumë gjasa të kushtoj më shumë se që supozon Banka Botërore, nuk mund të funksionoj aq sa është parashikuar dhe/ose kostot e tij operative mund të jenë dukshëm më të larta se që pritet.
- Asnjë bankë investuese ose grup bankash investuese nuk ka shprehur interesim të financoj këtë projekt, që është një indikacion se marrëveshja nuk është financiarisht e leverdishme.
- Deklaratat e fundit në mbështetje të projektit nga Banka Botërore dhe qeveria e SHBA-së i rrisin gjasat që kostoja e projektit të *Termocentralit* Kosova e Re të rritet edhe më shumë pasi që pjesëmarrësit në këtë proces zhvillimor e shfrytëzojnë përkrahjen politike për avantazhe financiare.
- Edhe pse qeveria e Kosovës ka bërë përmirësime të konsiderueshme viteve të fundit në proceset e faturimit, inkasimit dhe menaxhimit të humbjeve në tërë sistemin e saj të energjisë elektrike, megjithatë sistemi vazhdon të ketë humbje të të hyrave si pasojë e kontrolleve të dobëta të menaxhmentit. Të hyrat e dobëta mund të shkaktojnë probleme serioze në qarkullimin e parasë dhe të rrezikojnë pagesën e kredisë për ndërtimin e ri.
- Studimeve që janë bërë në mbështetje të termocentralit të propozuar u mungojnë të dhënat e sakta kohore, relevante, të detajuara dhe konsekuente teknike lidhur me ndërtimin, financat, operacionet, menaxhimin e shërbimeve ose statistikave sociale të nevojshme për të formuluar masat referuese ose parashikimet. Pas një dekade të zhvillimit, ende nuk ka konsensus për ndonjë plan të detajuar për termocentralin.

**IEEFA thekson se *Termocentrali Kosova e Re* do të krijonte një barrë të panevojshme për paguesit e tarifave dhe do të dëmtojë ekonominë e brishtë të Kosovës.**

**Megjithëse ministri kosovar i zhvillimit ekonomik deklaroi në nëntor të vitit 2015 se kostoja e ndërtimit të termocentralit do të jetë gjithsejtë 1 miliardë euro, IEEFA pret – bazuar në përvojën e kaluar me projekte të ngjashme të ndërtimit të termocentraleve me thëngjill – që vetëm kostoja e ndërtimit do të jetë gjithsejtë 1.35 miliardë euro, dhe kostoja e vërtetë e termocentralit, kur të jetë përfshirë financimi dhe subvencionet, do të arrijë së paku në 4.169 miliardë.**

IEEFA po ashtu thekson se Kosova ka alternativa ndaj ndërtimit të termocentralit të panevojshëm më një çmim kaq të paarsyeshëm. Studimet e pavarura, përfshirë edhe disa të bëra nga vet Banka Botërore, kanë treguar se zbatimi i masave për efikasitet të energjisë dhe instalimi i energjisë së ripërtërishme në Kosovë do të ishte më pak e kushtueshme se sa ndërtimi i një termocentrali më tërëgjill dhe do të stimulonte zhvillimin ekonomik, do të krijonte vende pune dhe do të shërbente si mbrojtëse afatgjate kundër rritjes të kostos së energjisë.

## I. Sfondi: Fushëveprimi i Projektit dhe Statusi Aktual

Republika e Kosovës, me një popullsi prej rreth 1,8 milionë banorësh, ka gjeneruar një mesatare vjetore të energjisë elektrike prej 5,375 GWh gjatë pesë viteve të fundit.<sup>1</sup>

Sistemi aktual përbëhet nga termocentralet të cilat kanë një kapacitet të përgjithshëm prodhues të energjisë elektrike prej 1,527 MW. Këto përfshijnë dy termocentralet me tërëgjill, të njohura si Kosova A dhe Kosova B, që kanë prodhuar mbi 95 për qind të energjisë elektrike të Kosovës në vitin 2014 dhe së bashku kanë një kapacitet prej 1,478 MW. Kosova ka edhe hidrocentrale me kapacitet prej 48 MW, dhe vendi prodhon një sasi të vogël të energjisë së erës.<sup>2</sup> Asetet e saj të prodhimit të energjisë nga tërëgjilli janë të vjetra dhe janë ndotës të mëdhenj, dhe sistemi i saj i transmisionit është i vjetëruar dhe i papërshtatshëm për një shtet të ri (Republika e Kosovës e ka shpall pavarësinë e saj nga Serbia në vitin 2008).

Që në fillim të vitit 2004,<sup>3</sup> Qeveria e Kosovës filloi të planifikojë një riorganizim të sistemit të saj të prodhimit të energjisë elektrike. Një rishikim nga qeveria identifikoi probleme operacionale, ndërprerje të paplanifikuara, emetime të larta dhe një mbështetje të tepruar në energjinë elektrike të importuar. Qeveria përcaktoi katër veprime kryesore për përmirësimin e rrjetit të saj të energjisë elektrike: 1) mbylljen e termocentralit Kosova A; 2) rehabilitimin e termocentralit Kosova B; 3) ndërtimin e një termocentrali të ri me tërëgjill, termocentralin Kosova e Re; dhe 4) investimin në një varg iniciativash të efikasitetit dhe iniciativave për energji të ripërtërishme.<sup>4</sup>

Gjatë disa viteve të fundit, projekti i Termocentralit Kosova e Re ka kaluar nëpër një varg ndryshimesh të projektit të shtyra nga konsideratat politike dhe teknike. Planet fillestare për të ndërtuar një termocentral prej 2,000 MW janë përshkallëzuar dhe kthyer në 600 MW për shkak të

<sup>1</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2014, [Electricity generation 2004-2014](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf), Figura 6.5, f. 17, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>2</sup> Energy Regulatory Office, Annual Report 2014, f. 35 dhe 36. [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>3</sup> LPTAP Dokumenti i Vlerësimit të Projektit 2006, f. 3-5, [http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006\\_09\\_13](http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006_09_13)

<sup>4</sup> Dokumenti i Bankës Botërore, 2012, Raporti Nr. 66877-XK, p. 22-23, [http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDS/IB/2012/05/07/000406484\\_20120507085250/Rendered/PDF/68770IDA0R201001400MIGA0R201200024.pdf](http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDS/IB/2012/05/07/000406484_20120507085250/Rendered/PDF/68770IDA0R201001400MIGA0R201200024.pdf)

mungesës së kërkesës.<sup>5</sup> Pastaj, planet për një termocentral me një njësi të vetme prodhuese prej 600 MW u ndryshuan për shkak të mungesës së kërkesës dhe për shkak të shqetësimeve se madhësia paraqiste probleme të mundshme në furnizim në rast të ndërprerjeve.<sup>6</sup> Kështu u propozuan dy njësi prodhuese prej 300 MW në vend të një njësie të vetme të madhe prej 600 MW në një termocentral që do prodhonte me kapacitet neto 560 MW (sepse 40 MW do të jenë të nevojshme për funksionimin e termocentralit), i cili do të përdorë teknologji të vjetruar dhe joefikase nën- kritike të një termocentrali me thëngjill.

Me 23 nëntor 2015, ministri kosovar i zhvillimit ekonomik, Blerand Stavileci, shpalli<sup>7</sup> versionin përfundimtar të termocentralit. Shpallja erdhi në formë të komenteve me gojë. Plani i ri redukton madhësinë e termocentralit nga 600MW në 500 MW dhe është subjekt i negociatave të mëtejshme. Më 18 dhjetor 2015 Qeveria e Kosovës, e kryesuar nga kryeministri Isa Mustafa, njoftoi për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për këtë projekt me ContourGlobal.<sup>8</sup>

Financimi i propozuar përfshin një kontribut prej 30 për qind përmes ekuitetit nga ContourGlobal, i vetmi ofertues për këtë projekt,<sup>9</sup> dhe pjesa e mbetur prej 70 për qind të financimit nga burime të jashtme. Banka Botërore ka premtuar mbështetje për këtë projekt, dhe ka dhënë tashmë fonde të konsiderueshme për asistencë teknike dhe për shpenzimet paraprake zhvillimore. Kushtet e fundit si të pjesëmarrjes së ContourGlobal përmes ekuitetit ashtu edhe të kredisë nga Banka Botërore dhe ndonjë huadhënës tjetër janë në diskutim e sipër.<sup>10</sup> Ministri i Zhvillimit Ekonomik thekson se dokumentet teknike do të kompletohen gjatë disa muajve të ardhshëm, dhe se ndërtimi do të fillojë në fund të vitit 2016 ose në fillim të vitin 2017 dhe do të duhen katër deri në pesë vjet për tu përfunduar.

Projekti ka pasur disa vonesa kohët e fundit, derisa Banka Botërore po i ri-shqyrton politikat e saj mbi ndryshimin e klimës, dhe sepse banka është distancuar nga financimi i termocentraleve me thëngjill. Aktualisht, Termocentrali Kosova e Re është një nga termocentralet e pakta të thëngjillit në botë të cilin Banka Botërore e konsideron të pranueshëm.<sup>11</sup>

---

<sup>5</sup> Shqyrtimi i raportit të përfundimit të zbatimit – Projekti i Asistencës Teknike për Energjinë nga Linjiti, <http://lnweb90.worldbank.org/oed/oeddoclib.nsf/DocUNIDViewForJavaSearch/8525682E0068603785257AC5006A5C1D?opendocument>

<sup>6</sup> Banka Botërore, Njësia e Sektorit të Energjisë, Rajoni i Evropës Qendrore dhe Azisë, Projekti i Termocentralit në Kosovë: Terma e Referencës, SFDCC Paneli i Ekspertëve, 14 qershor 2011

<sup>7</sup> <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,5394>

<sup>8</sup> [http://www.mzhe-ks.net/sq/lajmet/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-ne-mes-te-ministrise-se-zhvillimit-ekonomik-dhe-investitorit-amerikan-contour-global-2674#.VoZii\\_Vikp](http://www.mzhe-ks.net/sq/lajmet/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-ne-mes-te-ministrise-se-zhvillimit-ekonomik-dhe-investitorit-amerikan-contour-global-2674#.VoZii_Vikp)

<sup>9</sup> LPTAP Dokumenti i Vlerësimit të Projektit 2006, f. 77, [http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006\\_09\\_13](http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006_09_13)

<sup>10</sup> Gazeta Express, maj 2015, "Mospajtimet në mes të Bankës Botërore dhe "ContourGlobal" për termocentralin "Kosova e Re" <http://www.gazetaexpress.com/en/news/disagreements-between-the-world-bank-and-contour-global-on-the-kosova-e-re-power-plant-104154/?archive=1>

<sup>11</sup> US News, 2013, "The Real War on Coal Starts in Kosovo," <http://www.usnews.com/opinion/blogs/world-report/2013/07/22/the-war-on-coal-in-kosovo-and-the-world-bank>

# II.Struktura e Raportit, Metodologjia, dhe Komentet mbi Burimet e të Dhënave

## Struktura e Raportit të IEEFA

Përveç përmbledhjes së mësipërme ekzekutive, detajeve të gjendjes së përgjithshme (Seksioni I) dhe metodologjisë dhe të dhënave e informacioneve të përmbledhura këtu (Seksioni II), ky raport përmban edhe seksionet e mëposhtme:

**Seksioni III**, që përmbledh gjetjet kryesore të ndikimit të *Termocentralit Kosova e Re* (TCKR) në buxhetet familjare.

**Seksioni IV**, që detajon hapat e përdorur nga IEEFA për të përcaktuar kostot për ndërtimin TCKR-së, për ta mbajtur në funksion dhe për të prodhuar energji elektrike nga ai.

**Seksioni V**, që përshkruan një sërë faktorëve të rrezikut që mund të ndikojnë në modelin e tregut.

**Pjesa VI**, që analizon rolin e Bankës Botërore, politikat e saj për zbutjen e varfërisë dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, dhe rolin e saj potencial në subvencionimin e projektit të TCKR-së.

**Seksioni VII**, që diskuton potencialin për investime në energjinë e ripërtërishme dhe eficiencën e energjisë në Kosovë.

Raporti përmban dy shtojca. Shtojca I paraqet përmirësimet teknike në sistemet e të dhënave që do të ndihmonin planifikimin e energjisë në Kosovë. Shtojca II paraqet një diskutim më të detajuar të modelit financiar të përdorur në këtë raport për të nxjerr çmimin e energjisë elektrike.

# Metodologjia

IEEFA përdor dy llogaritje bazë për të krijuar një model për vlerësimin e ndikimit të Termocentralit Kosova e Re në çmimin e energjisë elektrike për kosovarët. E para është kostoja e energjisë elektrike që termocentrali do të prodhojë. E dyta është çmimi i energjisë elektrike që do tu bartet familjeve në faturat mujore; kjo përcaktohet nga bashkimi i koston së energjisë elektrike nga termocentrali i ri me çmimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë. (Ky raport përqendrohet në faturat e energjisë elektrike të familjeve e jo në faturat e sektorit industrial apo komercial). IEEFA pastaj vlerëson faktorët e rrezikut që mund të ndikojnë në operimin e termocentralit.

## Komponentët e Modelit

Për të përcaktuar koston e energjisë elektrike që do të prodhojë termocentrali, modeli identifikon se sa do të kushtonte termocentrali nëse zhvillohet duke përdorur modelin bazë të punës të përshkruar në studimet e planifikimit<sup>12</sup> të publikuara gjatë disa viteve të fundit për TCKR-në dhe njoftimin e fundit nga ana e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik.

IEEFA përdor informacionin e tregut në lidhje me koston e ndërtimit të termocentraleve, normat e interesit, koston e ekuitetit dhe shpenzimet operative të termocentraleve për të hartuar një "shportë e tregut" të shpenzimeve për Termocentralin Kosova e Re. Komponentët e shportës së tregut janë të shprehura në EUR/ MWh.

- Koston e borxhit (70 për qind e koston së ndërtimit) dhe koston e ekuitetit për projektin (30 për qind e koston së ndërtimit) përcaktohen në bazë të kostove të përgjithshme të ndërtimit (*shih Figurën 2: Kostoja e përgjithshme e vlerësuar për Termocentralin Kosova e Re*). Kostoja e ndërtimit është amortizuar gjatë një periudhe kohore të caktuar në përputhje me kushtet e investitorëve të borxhit dhe ekuitetit. Pjesa e koston së projektit që merret borxh supozon një normë interesi që paguhet nga pronari për përdorim afatgjatë të parave të huazuara për ndërtimin e termocentralit. Kostoja e ekuitetit përfshin një kthim për ekuitetin, i cili është i bazuar në vlerësimin e rrezikut që përcaktohet nga pronari i projektit dhe investitori i ekuitetit.
- Për të kuptuar se sa do të kushtojë operimi i termocentralit, duhet të llogaritet se sa energji elektrike në të vërtetë do të prodhojë. Kjo sasi përcaktohet duke aplikuar një faktor të llogaritur të kapacitetit, i cili është shprehur në megavat orë (MWh). Faktori i kapacitetit është një masë që krahason sasinë e energjisë që një termocentral faktikisht e prodhon brenda një viti me sasinë që do të kishte prodhuar në qoftë se ai do të vepronte me kapacitet të plotë për të gjitha orët në atë vit. Sa më i lartë faktori i kapacitetit, aq më shumë energji prodhon termocentrali në atë vit (*shih Figura 5: Faktori i kapacitetit*).
- IEEFA shumëzon koston e prodhimit të energjisë në termocentral me faktorin e kapacitetit. Kjo rezulton në një kosto të energjisë elektrike për TCKR-në, shprehur në Euro për megavat orë (EUR/MWh). (*Shih Figura 6: 2021 Kostoja e energjisë elektrike nga Termocentrali Kosova e Re*).

<sup>12</sup> LPTAP Dokumenti për Vlerësimin e Projektit, 2006, [http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006\\_09\\_13](http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006_09_13)

## Metodologjia (vazhdim)

IEEFA integron koston e energjisë elektrike nga termocentrali i ri në sistemin e përgjithshëm të energjisë elektrike, duke nxjerr një çmim të ri të vlerësuar të energjisë elektrike për familjet kosovare. Për ta bërë këtë llogaritje, IEEFA fillon me çmimin e energjisë elektrike në vitin 2014 për sistemin në tërësi dhe për familjet kosovare në veçanti, si kategori e paguesve të faturave (shih *Figurën A1: 2014 Çmimi e energjisë për konsumatorët jo-familjarë dhe familjarë në faqen 41*). IEEFA pastaj e përshtat çmimin e energjisë elektrike të sistemit nga 2015 deri në vitin 2021 për ta faktorizuar me një normë të inflacionit që pritet për të mbuluar shpenzimet e rëndomta dhe të zakonshme në sistem pa shtesën e TCKR-së. (Shih *Figurën A5: Rritja tipike e përqindjes vjetore të çmimit të energjisë elektrike nga 2015 deri në 2020 krahasuar me rritjen e çmimit gjatë vitit të parë të funksionimit të Termocentralit Kosova e Re*).

IEEFA pastaj bashkon koston e TCKR-së në numra për mbarë sistemin, duke pasqyruar se sa prej energjisë së përgjithshme të sistemit do të prodhohet nga TCKR-ja (shih *Figurën A2: 2021 Çmimi i sistemit të energjisë elektrike në Kosovë me Termocentralin Kosova e Re*). Llogaritjet përfundimtare nxjerrin një çmim për vitin 2021 për tërë sistemin e energjisë elektrike në Kosovë me TCKR-në.

Duke përdorur këtë informacion, IEEFA pastaj llogarit çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët familjar të Kosovës në vitin 2021 me dhe pa TCKR-në (shih *A3: Ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjar me dhe pa vitin e parë të funksionimit të Termocentralit Kosova e Re*). Për të llogaritur çmimin, IEEFA ka përdorur si model formën historike të përcaktimit të çmimeve nga qeveria e Kosovës për konsumatorët familjarë në raport me grupet e tjera të konsumatorëve.<sup>13</sup>

Studimi pastaj llogarit ndikimin e këtyre rritjeve të çmimeve në ekonominë familjare në Kosovë. Numrat në këtë seksion janë të paraqitur në Euro centë/ kWh (të cilat përdoren për shfrytëzim nga amvisëritë, shitje dhe faturim) e jo në EUR/ MWh (që përdoren në tërë studimin për të shpjeguar diskutimin më të gjerë të kostove dhe çmimit të sistemit).

*Figura A4: Përqindja e të ardhurave të paguara nga familjet kosovare në vitin 2015 para dhe pas Termocentralit Kosova e Re në vitin 2021 në faqen 43 ndan konsumatorët familjarë në tri kategori të të ardhurave – familjet me të ardhura mesatare për kokë banori, me të ardhura të ulëta dhe të mesme, si dhe ato në nivelin e varfërisë. Ndikimi i çmimit për secilin grup të të ardhurave është i drejtuar në dy modele të ndryshme të konsumit, një që përdor mesataren e konsumit të familjes prej 550 kWh në muaj dhe ai që përdor një model të konsumit më të ulët prej 300 kWh në muaj (shih *Figurën 1: Shfrytëzimi mesatar i energjisë elektrike nga ekonominë familjare në Kosovë , 2014*).*

IEEFA përdor këto nivele të konsumit për të llogaritur koston vjetore të energjisë elektrike për familjet kosovare dhe përcakton përqindjen e të ardhurave vjetore familjare që do tu duhen për të paguar energjinë elektrike para dhe pasi të filloj të operojë TCKR.

<sup>13</sup> Shih diskutimin për caktimin e tarifave dhe çmimeve në Seksionin VI për rolin e Bankës Botërore.



## Burimet e të dhënave

Si bazë për llogaritjet e saj IEEFA përdor informacionet nga burimet e mëposhtme: Dokumentet e planifikimit dhe teknike të Bankës Botërore të përgatitura nga komitetet e ndryshme, komisionet dhe konsulentët e pavarur, studimet e financuara nga organizatat ndërkombëtare, si USAID-i dhe Bashkimi Evropian; dhe informacionet mbi sistemin e energjisë elektrike të Kosovës nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE-ja) në Kosovë dhe KEK-u, Korporata Energjetike e Kosovës (ndërmarrje publike e Kosovës).

Përveç kësaj, IEEFA përdor të dhëna më të gjëra ekonomike dhe sociale nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Agjencia Qendrore e Inteligjencës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe shoqatat e ndryshme private dhe publike zhvillimore, bankare dhe financiare. IEEFA gjithashtu përdor informacionet e tregut rajonal për të mbështetur parashikimet e përdorura në këtë dokument, si dhe raportet e agjencive kreditore në disa nga subjektet private dhe publike të diskutuara dhe disa dokumente teknike të financuara nga organizatat joqeveritare që punojnë në Kosovë në çështjet që lidhen me termocentralin e propozuar.

Në përvojën e IEEFA, një projekt i menaxhuar në mënyrë profesionale i kësaj natyre zakonisht përfshin një sërë dokumentesh bazë që përshkruajnë projektin, financimin e tij, planin e biznesit, një përshkrim të marrëdhënies juridike të projektit me grupet e interesit, planet e ndërtimit dhe financimit dhe supozimet operative lidhur me lëndën djegëse, fuqinë punëtore, pajtueshmërinë mjedisore si dhe një bazë të dhënash që nënvizojnë supozimet sasiore të projektit. Dokumentet e tilla thelbësore janë në dispozicion të publikut dhe përditësohen shpesh. Megjithatë, asnjë grup thelbësor i dokumenteve për TCKR-në nuk është bërë publik.

Të dhënat e përdorura në këtë raport në përgjithësi vijnë nga qeveria e Kosovës ose nga organizatat ndërkombëtare që i përdorin me qëllim të raportimeve të përgjithshme makroekonomike ose specifike për energjinë në Kosovë. Sistemet e të dhënave sasiore të energjisë dhe të financave të energjisë që i shërbejnë qeverisë së Kosovës kanë kufizime të konsiderueshme. Shumica e dokumenteve të përgjithshme teknike të hartuara për të mbështetur *Termocentralin Kosova e Re* kanë kufizime të konsiderueshme, siç theksohet në tërë këtë raport. Analiza e TCKR-së do të përmirësohet shumë me statistika më të mira makroekonomike dhe sociale, planifikim energjetik dhe me futjen e të dhënave specifike në vlerësimet e termocentralit.<sup>14</sup>

Sistemet e të dhënave të plota lidhur me menaxhimin fiskal, financiar, ekonomik, energjetik të shërbimeve janë kritike për analizën publike dhe të investimeve. Dhjetë kërkesat e veçanta me shkrim nga organizatat e ndryshme me interes publik,<sup>15</sup> për informacion nga Qeveria e Kosovës

<sup>14</sup> Shih Shtojcën I: Shënim për Analizën e të Dhënave. Shih edhe diskutimin në këtë dokument për nën-grupet e të ardhurave, trajtimin nga ZRRE-ja të klasifikimit të shfrytëzuesve dhe raportimin konsekuent të çmimit të energjisë elektrike dhe diskutimin e përgjithshëm për caktimin e tarifave.

<sup>15</sup> Një seri prej 10 kërkesave për informata dhe përgjigjet e qeverisë janë paraqitur më poshtë dhe gjenden në këtë vegëz: [http://www.institutigap.org/documents/31883\\_Pergjigjet\\_refuzuese.pdf](http://www.institutigap.org/documents/31883_Pergjigjet_refuzuese.pdf)

- I. "Mos transparenca e Qeverisë së Kosovës për shitjen e KEDS dhe 'Kosova e Re,'" nga Konzorciumi i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë (KOSID), 9 tetor 2012.
- II. Kërkesa për informacione drejtuar Z. Bernard Atlan, International Finance Corporation, nga Agron Demi, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 18 korrik 2011.
- III. Kërkesa për informacione drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, nga Agron Demi, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 7 korrik 2011.

lidhur me transaksionet dhe planin e financimit dhe të funksionimit të TCKR-së në pjesën më të madhe kanë përfunduar pa përgjigje. Një kërkesë kohëve të fundit nga KOSID për një kopje të Memorandumit të Mirëkuptimit<sup>16</sup> të nënshkruar më 18 dhjetor 2015 u refuzua nga Qeveria e Kosovës me arsyetimin se negociatat janë ende duke u zhvilluar. Edhe pse IEEFA ka përfshirë disa komponentë në modelimin e saj bazuar në njoftimin e qeverisë, këto inpute sasiore vijnë me një shkallë të lartë të rrezikut.<sup>17</sup>

Njoftimi i fundit nga qeveria e Kosovës për ri-dizajnimin e TCKR-së në Kosovë paraqet përkeqësim të mëtejshëm të angazhimit edhe ashtu të dobët ndaj hapjes dhe transparencës. Pas më shumë se një dekade të projektimit, ri-dizajnimin dhe dështimit për të realizuar standardet e projektit. Qeveria e Kosovës ka zgjedhur tani të shpall këtë skenarin e fundit pa dokumente mbështetëse, pa një plan të punës (biznesi), dhe vetëm me angazhime financiare të paspecifikuara për shumicën e financave të projektit.

## III. Ndikimi i Termocentralit Kosova e Re në Familjet Kosovare

### A. Sfondi për dinamikën e të ardhurave dhe çmimit të energjisë elektrike në Kosovë

Kosova është ndër vendet më të varfra në Evropë,<sup>18</sup> sipas të dhënave të Bankës Botërore. Banka Botërore përmend të ardhura bruto për kokë banori në Kosovë për vitin 2017 prej 3,597 € (afërsisht US \$ 4,000) në vit.<sup>19</sup> Të ardhurat për kokë banori për familjet me të ardhura të ulëta

- IV. Përgjigja nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës për Institutin për Studime të Avancuara GAP, 25 korrik 2011.
- V. Kërkesa për qasje në dokumentet publike drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nga Krenar Shala, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 1 dhjetor 2011.
- VI. Përgjigja nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës për Krenar Shalën, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 5 dhjetor 2011.
- VII. Kërkesa për qasje në dokumentet publike drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nga Antigona Berisha, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 8 mars 2012.
- VIII. *Përgjigja nga Zyra për Komunikim Publik*, Nr. 1/12, për Antigona Berishën, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 14 mars 2012.
- IX. Kërkesa për qasje në dokumentet publike drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nga KOSID (*Konsorciumi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm*), pa datë.
- X. Përgjigja nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik referencë Nr. 22/12 për Antigona Berishën, Instituti për Studime të Avancuara – GAP, 1 gusht 2012.

<sup>16</sup> Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar nga ContourGlobal, megjithatë ajo nuk ka lëshuar asnjë komunikatë të pavarur të shtypit lidhur me projektin. Një shqyrtim i faqes së internetit të ContourGlobal tregon se ata shpesh shpallin projekte në faza të ndryshme të procesit zhvillimor kur arrihen standarde të rëndësishme. <http://www.contourglobal.com/media?page=3>

<sup>17</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Memorandumi i Mirëkuptimit, 29 dhjetor 2015, [http://ieefa.org/wp-content/uploads/2016/01/Pergjigje-ndaj-kerkeses-tuaj-per-qasje-ne-dokumente-publike-me-nr.-protokolli-3005-12\\_29\\_2015.pdf](http://ieefa.org/wp-content/uploads/2016/01/Pergjigje-ndaj-kerkeses-tuaj-per-qasje-ne-dokumente-publike-me-nr.-protokolli-3005-12_29_2015.pdf)

<sup>18</sup> Lista e shteteve sovraane në Evropë sipas GNI (nominale) për kokë banori

<sup>19</sup> Banka Botërore, Kosovë, <http://data.worldbank.org/country/kosovo>

dhe të mesme<sup>20</sup> në Kosovë janë 2,575 € (US \$ 2,946) në vit, dhe të ardhurat bruto për kokë banori për 29.7 për qind<sup>21</sup> të popullsisë së Kosovës që jeton nën kufirin e varfërisë janë 635 € (US \$ 726) në vit.<sup>22</sup>

Derisa çmimi i energjisë elektrike në Kosovë është i ulët në raport me vendet fqinje,<sup>23</sup> kostoja e energjisë elektrike konsumon një pjesë joproporcionalisht të lartë të të ardhurave të familjeve kosovare. Për qëllimet e këtij raporti, IEEFA vë çmimin aktual të energjisë elektrike në 5.24 euro centë / kilovat orë (kWh).<sup>24</sup>

Familjet evropiane rrallë paguajnë mbi 6 për qind të të ardhurave të tyre për energji elektrike.<sup>25</sup> Për dallim prej tyre, familjet kosovare që kanë blerë një sasi mesatare të energjisë elektrike në vitin 2015 (550 MW në muaj)<sup>26</sup> kanë paguar pak më shumë se 9.6 për qind të të ardhurave të tyre vjetore për energjinë elektrike. Familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme kanë paguar 13.4 për qind të të ardhurave të tyre vjetore për energjinë elektrike, dhe familjet e varfra, të cilat kishin blerë një sasi të vogël të energjisë elektrike, kanë paguar 29.7 për qind të të ardhurave të tyre vjetore për energjinë elektrike.

Agjencia e Statistikave të Kosovës thotë se 44 për qind e kosovarëve kanë pasur probleme që të paguajnë faturat e tyre për strehim, energji elektrike, taksa dhe ngrohje në vitin 2014.<sup>27</sup> Për këtë 44 për qindësh, buxhetet familjare ishin – dhe janë – të rënduara. Një rritje në një fushë të shpenzimeve familjare do të thotë se familja duhet të reduktojë shpenzimet për nevojat tjera themelore. Kjo është arsyeja pse çmimi i energjisë elektrike në Kosovë, i cili ka qenë në rritje të

<sup>20</sup> Për qëllime të këtij dokumenti ne përdorim statistikën e të ardhurave bruto kombëtare për kokë banori të ofruara nga Banka Botërore. Ne e përshtatim atë shifër për .716 për të nxjerr masat e të ardhurave të ulëta dhe të mesme. Kjo është disi masë arbitrare pasi që Banka Botërore nuk përcakton ndonjë standard gjithëpërfshirës brenda vendeve për definicionin e nëngrupeve të të ardhurave. Në vend të kësaj metoda e Bankës Botërore përdoret për krahasimin e sistemet ekonomike kombëtare. Ne këtu përdorim një raport të përafërt në mes të çmimit mesatar blerës dhe të ardhurave mesatare (Banka Botërore, "Të hyrat kombëtare bruto për kokë banori 2014, metoda Atlas dhe PPP," <http://databank.worldbank.org/data/download/GNIPC.pdf>). Ne përdorim masën e varfërisë të paraqitur nga Banka Botërore në 2015 prej 1.74 euro në ditë. Ky grup i pasaktë i masave të shpërndarjes së të ardhurave përdoret sepse në qeveria e Kosovës nuk përgatit kurrfarë të dhënash për shpërndarjen e të ardhurave sipas ekonomive familjare. Agjencia e Statistikave të Kosovës përgatit anketën vjetore të buxhetit të ekonomive familjare për të monitoruar format e konsumit të tyre. (Republika e Kosovës, të dhënat e ASK-së, <http://ask.rks-gov.net/ENG/hbs/tables>). Të dhënat e përgjithshme për të ardhurat kombëtare bruto për kokë banori që përdoren në Kosovë dhe në tërë Evropën janë të dobishme për të kuptuar trendet e pasurisë kombëtare, por jo edhe shpërndarjes së të ardhurave. (Për diskutim më të plotë për përparësitë dhe kufizimet e këtij lloji raportimi të të hyrave shih, EuroStat, "Income distribution statistics," [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Income\\_distribution\\_statistics](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Income_distribution_statistics)). Ne kemi ndërtuar një strukturë tri shtresore të të ardhurave në Kosovë për të paraqitur një perspektivë për ndikimet e çmimeve të energjisë elektrike në nëngrupet e ndryshme në vend.

<sup>21</sup> Republika e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2014, Tabela 10.7: Vitet e Përgjithshme të Varfërisë Ekstreme 2003-2011.

<sup>22</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e vendit, prill 2015," p. 6, <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

<sup>23</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2014, p. 66, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>24</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2014, p. 51, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>25</sup> Vaasa Global Energy, "European Residential Energy Price Report," 2013, p. 27, [http://www.vaasaett.com/wp-content/uploads/2013/05/European-Residential-Energy-Price-Report-2013\\_Final.pdf](http://www.vaasaett.com/wp-content/uploads/2013/05/European-Residential-Energy-Price-Report-2013_Final.pdf)

<sup>26</sup> Kjo shifër është nxjerr nga Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Vështrim për vendin, prill 2015," p. 48, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf). Konsumi total familjar në vitin 2014 është 2,063,000 MWh. Kjo shifër pjesëtohet me 309,700 familje siç vlerësohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës, "Balanci Afatgjatë i Energjisë së Republikës së Kosovës 2015-2024," p. 7, [http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Long-Term\\_Energy\\_Balance\\_of\\_the\\_Republic\\_of\\_Kosovo\\_2015\\_-\\_2024.pdf](http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Long-Term_Energy_Balance_of_the_Republic_of_Kosovo_2015_-_2024.pdf)

<sup>27</sup> Republika e Kosovës, Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare, p. 28. <https://ask.rks-gov.net/ENG/hbs/publications>

vazhdueshme gjatë viteve të fundit, ka krijuar shumë trazira në publik.

## B.Sistemi aktual: Çmimi dhe përdorimi shtëpiak

Sipas sistemit aktual të Kosovës, ritjet e kostove të sistemit të energjisë elektrike nuk kalojnë direkt përmes konsumatorëve familjarë, komercial apo industrialë. Çmimi i energjisë elektrike që u ngarkohet kosovarëve është i bazuar në një plan tarifor<sup>28</sup> që publikohet nga qeveria. Plani tarifor i klasifikon konsumatorët sipas grupit të shfrytëzuesve dhe cakton norma të ndryshme në varësi të vëllimit të përdorimit dhe kohës. Procesi i caktimit të tarifave ka transparencë të kufizuar, dhe është i bazuar në një balancimin e ekuiteteve në mes të konsumatorëve familjarë, industrial dhe komercial.

Në Kosovë janë 309,700 familje/amvisëri (shih figurën 1). Në vitin 2014, një familje mesatare në Kosovë ka paguar 5.24 euro centë / kWh për energji elektrike. Konsumatorët komercial kanë paguar 9.53 euro centë /kWh dhe konsumatorët industrial kanë paguar 5.45 euro centë/ kWh.<sup>29</sup> Sistemi në tërësi u kushton konsumatorëve kosovarë të energjisë elektrike mesatarisht 7 euro cent /kWh.

Për të matur ndikimet e ndryshme të mundshme të *Termocentralit Kosova e Re* në familjet e ndryshme, IEEFA përdor dy shembuj kryesorë: familjen mesatare, që shfrytëzon 555 kWh në muaj dhe një familje që shfrytëzon një sasi më të ulët të energjisë elektrike, 300 kWh në muaj.

**Figura 1: Shfrytëzimi mesatar i energjisë elektrike nga familjet në Kosovë, 2014<sup>30</sup>**

Faturimi dhe njësitë shtëpiake		Sasi
Gjithsej faturimi - Të gjithë konsumatorët	kwh	3,651,870,000
Ekonomitë familjare (56.5%)	kwh	2,063,365,500
Gjithsej ekonomi familjare <sup>31</sup>	Njësitë	309,700
Mesatare konsumi vjetor familjar	kwh	6,662
Konsumi mujor mesatar familjar	kwh	555

<sup>28</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2014, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>29</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti Vjetor 2014, p. 51, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>30</sup> Përveç totalit të ekonomive familjare, të gjitha shifrat tjera janë gjetur në Raportin Vjetor 2014 të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, p. 48, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>31</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, "Balanci afatgjatë i Energjisë së Republikës së Kosovë 2015-2024," p. 7, [http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Long-Term\\_Energy\\_Balance\\_of\\_the\\_Republic\\_of\\_Kosovo\\_2015\\_-\\_2024.pdf](http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Long-Term_Energy_Balance_of_the_Republic_of_Kosovo_2015_-_2024.pdf)

## C. Çmimi i energjisë elektrike në vitin 2021 pa Termocentralin Kosova e Re

Edhe pse kosovarët kanë përjetuar rritje të konsiderueshme të çmimit të energjisë elektrike në të kaluarën e afërt, ka të ngjarë që do të ketë edhe më shumë rritje nga 2016 deri 2021, para se TCKR të fillojë ndonjëherë së funksionuari. Duke supozuar një rritje prej 2 për qind në vit, tarifat e energjisë elektrike në Kosovë do të rriten nga 5.24 euro centë / kWh në vitin 2014 në 5.9 euro centë/ kWh deri më 2021. Këto rritje shkaktohen nga kostot e rëndomta dhe të zakonshme të operimit dhe mirëmbajtjes së një sistemi të energjisë elektrike dhe nga kufizimet politike në rritjen vjetore të çmimeve.

## D. Kostoja e energjisë elektrike nga Termocentrali Kosova e Re

IEEFA vlerëson se kostoja - pasi të jenë përfshirë të gjitha - e energjisë elektrike nga Termocentralin Kosova e Re do të jetë 128 euro/MWh kur ai të hapet në 2021. Kostoja e prodhimit të energjisë –pasi të përfshihen të gjitha- në vitin 2015 në sistemin aktual operativ është 28.93 euro/MWh. Kështu, kostoja e energjisë nga termocentralit të ri do të jetë katër herë më e lartë se kostoja e energjisë në sistemin aktual.

## E. Ndikimi i Termocentralit Kosova e Re në çmimin e energjisë elektrike

Energjia elektrike nga TCKR-ja do të jetë e shtrenjtë. Çmimi i energjisë elektrike që u ngarkohet kosovarëve do të rritet ndjeshëm nëse TCKR-ja futet në prodhim. Për shkak të mënyrës se si caktohen tarifat e energjisë elektrike në Kosovë, shkalla e rritjes së çmimeve do të jetë vendim politik. Megjithatë, IEEFA vlerëson se bazuar në bilancin aktual të ekuiteteve në mes të sektorit familjar, komercial dhe industrial, futja e energjisë elektrike të TCKR-së në sistem do të rezultojë në një rritje minimale e çmimit prej 33.8 për qind, nga 5.9 euro centë/ kWh në 7.9 euro centë / kWh për ekonomitë familjare në Kosovë.<sup>32</sup> Çfarë ka më shumë të ngjarë është që çmimet e energjisë elektrike për familjet të rriten me 50 për qind.

Një rritje prej 33.8 për qind në koston e energjisë elektrike do të ketë ndikimet e mëposhtme:

- Shpenzimet vjetore të familjeve me të ardhura mesatare për kokë banori për energji elektrike do të rriten në 12.9 për qind të të ardhurave të tyre vjetore.
- Shpenzimet vjetore të familjeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme për energjinë elektrike do të rriten në 18 për qind të të ardhurave të tyre vjetore.
- Familjet nën pragun e varfërisë do të paguajnë më shumë se 39.7 për qind të të ardhurave të tyre vjetore për energji elektrike.

<sup>32</sup> Shih Shtojcën II për një paraqitje të detajuar të metodologjisë së përdorur për këto llogaritje.

Futja në funksion e *Termocentralit Kosova e Re*, nën këto supozime, do të minonte hapat për të bërë energjinë elektrike më të përballueshme për shumicën e kosovarëve dhe do të mbante energjinë elektrike pothuaj të paarrishme për njerëzit më të varfër në Kosovë.

Këto vlerësime për rritjen e çmimeve janë shumë konservative (shih Seksioni V: Rreziqet). Faktorët e tjerë të rrezikut mund të rrisin edhe më shumë çmimin e energjisë elektrike. Këta faktorë të rrezikut janë të lidhur me koston përfundimtare të impiantit, supozimet e biznesit që nuk janë vendosur ose shpalosur ende, performancën e termocentralit, normat e interesit, ndryshimet politike dhe përmirësimet e sistemit. Pastaj, ndikimet e llojit dhe madhësisë së TCKR-së në buxhetin e Qeverisë së Kosovës janë të panjohura.

## IV. Llogaritjen e koston së energjisë elektrike nga *Termocentrali Kosova e Re*: Një model

IEEFA ka nxjerrë një kosto të energjisë elektrike nga *Termocentrali Kosova e Re* bazuar në një model financiar që siguron një kuptim referues të koston së termocentralit në kushtet aktuale dhe të projektuara ekonomike.

Kostoja e energjisë elektrike nga TCKR-ja, si në çdo impiant tjetër gjenerues, pasqyron koston e saj kapitale, koston operative vjetore dhe të mirëmbajtjes (fikse dhe variabile), dhe performancën operative të saj. Kur termocentrali të jetë funksional ai bëhet pjesë e portofolit të burimeve të energjisë elektrike të Kosovës. Në Kosovë ky portofol është i përbërë kryesisht nga energjia e prodhuar nga thëngjilli, një sasi energjie hidroelektrike dhe sasia e energjisë së importuar. Kostoja e energjisë elektrike nga TCKR bëhet bashkë me koston e pjesës tjetër të sistemit. Rezultat i kësaj është një çmim i ri i energjisë elektrike për familjet. Kostoja e energjisë elektrike nga TCKR kalon nga termocentrali përmes sistemit kosovar të rregullimit të çmimeve tek konsumatorët familjarë në faturat mujore si ngarkesë e shprehur në euro centë për kwh.

### A. Kosto kapitale: Kostoja e ndërtimit

Ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në çmimin e energjisë elektrike nga një termocentral me thëngjill janë koston e ndërtimit dhe financimit të tij. Për fat të keq, ka informata shumë të kufizuara në dispozicion për koston e vlerësuar aktualisht të ndërtimit të termocentralit të propozuar me thëngjill TCKR. Në fakt, informacioni i vetëm në dispozicion publik për këtë termocentral është pretendimi se ajo do të kushtojë 1 miliardë euro dhe do të fillojë punën katër deri në pesë vjet pas fillimit të ndërtimit në fund të vitit 2016 apo 2017. Kështu, pyetjet kyçe mbeten pa përgjigje.


Së pari, qeveria nuk ka deklaruar nëse shifra 1 miliardë euro është një vlerësim i koston "brenda natës" (vetëm për ndërtim) apo "duke përfshirë të gjitha". Një vlerësim "brenda natës" pasqyron koston inxhinierike dhe të ndërtimit të cilat do të jenë të nevojshme për të ndërtuar një fabrikë brenda natës, prandaj nuk përfshin koston e përshkallëzimit apo financimit. Një vlerësim i

“të gjitha kostove” përfshin kostot e përshkallëzimit dhe financimit, dhe për këtë arsye pasqyron më arsyeshëm se cila do jetë kostoja faktike e ndërtimit të termocentralit, duke supozuar se të gjitha kostot njihen në mënyrë të arsyeshme dhe se përkrahësit janë duke qenë të sigurtë me publikun.

Së dyti, nuk është e qartë nëse të gjitha kostot e pritshme inxhinierike, të prokurimit dhe ndërtimit për TCKR-në janë të përfshira në shumën e vlerësuar prej 1 miliardë eurosh. Në mënyrë më të veçantë, nuk ka siguri për atë se cilat kontrole të emetimit janë të përfshira dhe nëse këto kontrole do të plotësojnë kushtet rregullative që pritet të jenë në fuqi kur termocentrali të jetë operacional.

Për shkak të kësaj pasigurie, IEEFA ka bërë një varg vlerësimesh të kostos për Termocentralin Kosova e Re që shkojnë nga kostoja e ulët prej 1 miliardë euros deri në kosto të lartë prej 1,44 miliardë eurosh. Këto shpenzime janë paraqitur në Figurën 2 më poshtë.

**Figura 2: Kostot totale për Termocentralin Kosova e Re**



Ana e ulët e këtij rangimi të kostove të ndërtimit të paraqitur në Figurën 2 supozon se kostoja e shpallur kohëve të fundit për TCKR-në ishte një vlerësim "i të gjitha kostove" (all-in) që përfshinte edhe kostot e përshkallëzimit dhe financimit.


Vlerësimi i kostos së mesme prej 1,35 miliardë eurosh të paraqitur në Figurën 2 supozon se vlerësimi i fundit ishte vetëm për një kosto "brenda natës" për TCKR-në dhe i shton kostot e përshkallëzimit dhe financimit, duke supozuar se ndërtimi fillon në vitin 2016 dhe termocentrali fillon operacionet në fillim të 2022. Një kosto vjetore e borxhit prej 7 për qind është përdorur për

të përcaktuar koston vjetore të financimit e ndërtimit të TCKR-së. Një normë vjetore prej 2.4 për qind e përkallëzimit të koston është përdorur edhe në këtë llogaritje, që paraqet normën mesatare vjetore të inflacionit në Kosovë gjatë pesë viteve të fundit.

Llogaritja e tretë e koston është bazuar në koston e raportuar përfundimtare të termocentralit me thëngjill Šoštanj 6 e përfunduar kohët e fundit në Slloveni. Ky termocentral është përfunduar në fund të vitit 2014 me një kosto prej 1.43 miliardë eurosh. IEEFA e ka përshtatur këtë kosto për të reflektuar madhësinë më të vogël të TCKR-së së propozuar (500 MW krahasuar me 600 MW në Sostanj 6) dhe faktin se ndërtimi i TCKR-së do të ndodh rreth shtatë vjet më vonë se ndërtimi në Sostanj 6, me një datë të futjes në shërbim me 2022.

IEEFA përdor vlerësimin e koston së mesme (1.35 miliardë euro) në modelin e saj të çmimeve të energjisë elektrike në Kosovë. Edhe në qoftë se shifra prej 1 miliardë eurosh e shpallur kohët e fundit nga qeveria është vlerësim “i të gjitha koston”, ajo mund të mos përfaqësojë koston reale. Shumë projekte të termocentraleve me thëngjill kanë kosto më të lartë se parashikimet dhe kanë gjatë ndërtimit. Për shembull, siç paraqitet në Figurën 3 më poshtë, kostoja përfundimtare prej 1,43 miliardë eurosh e termocentralit të thëngjillit në Šoštanj 6 ishte më shumë se dyfishi i koston prej 637 milionë eurosh sa ishte llogaritur fillimisht për projektin në vitin 2006.

**Figura 3: Rritja e koston të ndërtimit të termocentralit me thëngjill Šoštanj 6**



Rrjedhimisht, kostoja aktuale për të ndërtuar TCKR-në mund të jetë dukshëm më shumë se 1 miliard euro, dhe mund të jetë mbi 1.35 miliardë dollarë.



## B. Financimi i borxhit: Kostoja e normës së interesit

Për qëllimet e këtij raporti, IEEFA merr një kosto të mesme të ndërtimit për TCKR-në prej 1.35 miliardësh. Planet e publikuara më herët supozojnë një përpjesëtim prej 70 për qind borxh dhe 30 për qind ekuitet (kapital). Ministri i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës ka konfirmuar këtë strukturë të kapitalit në njoftimin e tij të fundit. IEEFA supozon se *Termocentrali Kosova e Re*, pra, do të ketë 945,000,000 € borxhe dhe 405,000,000 € ekuitet. Kostoja e bartur e borxhit është 34,93 EUR/MWh dhe kostoja e kapitalit është 40,97 EUR/MWh (shih Tabelën 5: Çmimi i energjisë elektrike nga *Termocentrali Kosova e Re*).

IEEFA përdor normën e interesit prej 7.5 për qind të shpallur kohët e fundit për pjesën e financimit që është borxh për *Termocentralin Kosova e Re*. IEEFA supozon se kjo është një normë interesi e subvencionuar. Burimi i fondeve dhe termat dhe kushtet nuk janë përcaktuar në njoftimin e fundit.

IEEFA gjithashtu supozon se norma reale e interesit në këtë projekt do të jetë mbi 18 për qind, nëse jo edhe më e lartë. Te kjo shifër është arritur bazuar në një vlerësim të faktorëve cilësorë që përballen me tregjet financiare të Kosovës dhe nga një shqyrtim i trendeve të normës së interesit për huadhënien tregtare që nga viti 2004 (shih Faktorin e Rrezikut Nr. 2). Megjithatë, një kredi për *Termocentralin Kosova e Re* do të jetë e pazakontë në shumë aspekte.<sup>33</sup> Nuk ka termocentrale të tjera me thëngjill që financohen në Kosovë, pjesa e borxhit të termocentralit, 945 milionë, është jashtëzakonisht e madhe, dhe kredia paraqet rreziqe të shumta politike dhe rregullative. Kredia sipas të gjitha gjasave do të klasifikohet si një kredi për industrinë e energjisë elektrike e marrë nga një korporatë jo-financiare.<sup>34</sup>

Nga viti 2004 deri në vitin 2011, normat komerciale të kreditimit në Kosovë ishin rreth 14 për qind me disa norma që shkonin deri në 16.6 për qind.<sup>35</sup> Në disa vitet e fundit normat për kreditë komerciale në Kosovë janë përmirësuar dhe tani janë përgjithësisht nën 10 për qind.<sup>36</sup> Ndërkohë që normat e interesit në vitin 2015 janë përgjithësisht rreth 10 për qind<sup>37</sup> - më të ulëta se nivelet historikisht të larta prej 14 për qind<sup>38</sup> - madhësia, kompleksiteti dhe karakteristikat unike të një kredie prej 945 milionë eurosh në Kosovë rrit profilin e rrezikut të transaksionit. Normat për huadhënien komerciale kanë qenë zakonisht më të larta se normat mesatare të interesit. Për këtë termocentral me thëngjill dhe kërkesat specifike që i vendos mbi huamarrësin dhe huadhënësin, një supozim i interesit prej 18 për qind është konservativ.

Njoftimi nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik nuk përcakton një normë reale të tregut të interesit për projektin. Ai nuk trajton nivelin e subvencionit të kërkuar. Një subvencion nga një normë tregu

<sup>33</sup> Në gusht 2006 qeveria identifikoi katër konzorciume ndërkombëtare të interesuara në këtë projekt dhe kontaktoi me Bankën Botërore për të shfrytëzuar garancitë e saj kreditore për projektin. Banka Botërore, "Termat e Referencës së Projektit të Energjisë në Kosovë për Panelin e Ekspertëve SFDC" p. 3-4.

[http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/110621\\_Kosovo\\_SFDC\\_Expert\\_Panel\\_TOR.pdf](http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/110621_Kosovo_SFDC_Expert_Panel_TOR.pdf),

<sup>34</sup> Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti për Normën e Interesit, Versioni 2.0, p. 31 for loan classification, [http://www.bqk-kos.org/repository/docs/Interest\\_Rates\\_Report.pdf](http://www.bqk-kos.org/repository/docs/Interest_Rates_Report.pdf)

<sup>35</sup> Shoqata e Bankave të Kosovës ", Studim krahasues mbi mjedisin e biznesit dhe roli i sektorit bankar në Kosovë" Sllajdi: Normat e interesit të kredive, p. 9, <http://bankassoc-kos.com/wp-content/uploads/2013/09/KBA-Research-Study-final.pdf>.

<sup>36</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e Vendit, prill 2015," <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

<sup>37</sup> Ibid.

<sup>38</sup> Instituti Riinvest ", Sektori bankar: Lehtësues apo pengues", <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/53.pdf>

prej 18 për qind në 7.5 për qind do të jetë afërsisht 1.7 miliardë euro për kohëzgjatjen e kredisë. Njoftimi nuk ka identifikuar burimin e ndonjë subvencioni apo ndonjë konsorcium të kreditorëve privatë të gatshëm që vërtetë të japin kredi në këto kushte.

## C. Kostoja e financimit përmes ekuitetit

IEEFA supozon se zhvilluesi i përcaktuar i projektit do të sigurojë 30 për qind të financimit përmes ekuitetit për këtë marrëveshje.<sup>39</sup> ContourGlobal u përcaktua së fundmi si ofertuesi i preferuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik.<sup>40</sup> ContourGlobal është i vetmi ofertues në këtë projekt. Ajo ishte e vetmja kompani që u përgjigj në tenderin e qeverisë së Kosovës në shkurt të vitit 2015.<sup>41</sup>

Strategjia afariste e ContourGlobal përqendrohet në projektet e infrastrukturës në vende me rrezik të lartë dhe mbështetet mbi shkallë të lartë të fitimit për investimet e bëra. Duke pasur parasysh pozitën relative të kompanisë dhe modelin e saj të biznesit, infuzioni i kapitalit prej 405 milionë euro të ofruara nga kompania do të bart një normë kthimi prej 21.5 për qind.<sup>42</sup> IEEFA supozon një orar agresiv pesëvjeçar të kthimit të principalit, duke e pasqyruar profilin e tanishëm të rrezikut të kompanisë dhe pozitën e saj të privilegjuar si kompania e preferuar.

ContourGlobal zotëron dhe operon projekte të energjisë në Evropë, Afrikë, Karaibe, Amerikën e Jugut dhe në Shtetet e Bashkuara.<sup>43</sup> Përveç kësaj, kompania ka në ndërtim e sipër pesë projekte që arrijnë në 215 MW të kapacitetit gjenerues në vende të ndryshme<sup>44</sup> (Kompania nuk e ka të shënuar TCKR-në ndër projektet që ka në plan t'i fus në operim komercial gjatë dy viteve të ardhshme).<sup>45</sup> Projektet që ContourGlobal i ka në listën e saj të zhvillimit janë një përzjerje e thëngjillit, gazit natyror, erës, hidrike, diellore, biomasës dhe naftës.

ContourGlobal aktualisht ka 1,9 miliardë dollarë në borxhe të nënshkuara për të pranuar detyrimet nga rrjedha e parave nga projektet e saj ekzistuese për investitorët e saj. Kompania përdor garancinë e secilit projekt për të rritur kontributet e ekuitetit të saj. Kështu, modeli i biznesit të kompanisë është shumë i ndjeshëm ndaj rreziqeve të ekzekutimit gjatë procesit të zhvillimit dhe ndërtimit. Natyra shumë e pasigurt e biznesit (me më shumë borxhe se sa kapital) e bën atë shumë të varur nga rrjedha stabile e parasë nga projektet e saj. Kompania përpiket të diversifikohet dhe në këtë mënyrë të forcojë pozitën e saj të përgjithshme të rrjedhës së parasë<sup>46</sup>

<sup>39</sup> Skema e dhënë në vlerësimin e projektit në vitin 2006, supozon një ndarje prej 70 me 30 në raportin mes borxhit dhe ekuitetit (kapitalit) dhe një kthim për ekuitetin prej 18 për qind. Shih: LPTAP Dokumenti i Vlerësimit të Projektit 2006, [http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006\\_09\\_13](http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006_09_13)

<sup>40</sup> Sekretari i Shtetit i Shteteve të Bashkuara ka pranuar edhe rolin e ContourGlobal për partneritet: <http://www.state.gov/secretary/remarks/2015/12/250260.htm>

<sup>41</sup> Reuters ", ContourGlobal mund të fillojë ndërtimin e termocentralit Kosova në vitin 2016", shkurt 2015, <http://in.reuters.com/article/2015/02/04/kosovo-energy-contourglobal-idINL6N0VE2DW20150204>

<sup>42</sup> ContourGlobal dhe Banka Botërore kanë pranuar një mosmarrëveshje mbi normën e kthimit. ContourGlobal ka kërkuar me sa duket për 25%. Shih: Gazeta Express, "Modeli armen për 'Kosovën e Re,'" <http://www.gazetaexpress.com/lajme/modeli-armen-per-kosoven-e-re-78370/?archive=1>

<sup>43</sup> Moody's Investor Service, "Rating Action: Moody's assigns B2 to ContourGlobal's proposed \$350 million senior secured term loan," [https://www.moody.com/research/Moodys-assigns-B2-to-ContourGlobals-proposed-350-million-senior-secured-PR\\_256985](https://www.moody.com/research/Moodys-assigns-B2-to-ContourGlobals-proposed-350-million-senior-secured-PR_256985)

<sup>44</sup> Moody's Investor Service, *Contour Global L. P. – Successful delivery of new assets would reduce concentration and development risks, both credit positive*, Credit Focus, November 5, 2014. (Moody's Credit Focus)

<sup>45</sup> Ibid.

<sup>46</sup> Ibid.

duke shtuar më shumë zhvillim dhe blerje. Raporti i nëntorit 2014 i Moody's Investors Services për kompaninë thotë se në qoftë se ContourGlobal mund të operacionalizojë pesë projektet e reja të propozuara të saj do të arrinte dy qëllime të rëndësishme: diversifikimin e rrjedhës së parasë dhe uljen e ekspozimit ndaj vendeve politikisht të rrezikshme.<sup>47</sup>

ContourGlobal kohët e fundit ka përjetuar probleme të mëdha financiare në termocentralin e saj me thëngjill Maritsa<sup>48</sup> në Bullgari për shkak të ndryshimeve në qeverinë bullgare. Kompania u përball me vonesa të konsiderueshme dhe në fund u detyrua që të ri-negociojë marrëveshjen dhe të pranojë pagesa më të ulëta (megjithëse të supozuara më të qëndrueshme).<sup>49</sup> Kjo është e rëndësishme për shkak se projekti Maritsa përbën 37 për qind të të ardhurave të ContourGlobal para interesit, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA), një nivel përqendrimi që krijon ekspozim financiar për kompaninë dhe ndikon në rrjedhën e parave të saj.

Sipas ministrit të zhvillimit ekonomik të Kosovës, projekti do të ketë një normë kthimit për pjesën e ekuitetit të projektit prej 21.5 për qind. Kjo është më e ulët se kërkesat e mëparshme të ContourGlobal për një kthim prej 23 për qind deri në 27 për qind.<sup>50</sup> Është e paqartë nëse kjo normë kthimi do të jetë subjekt i negociatave të mëtejshme. Pranimi i qartë nga qeveria e Kosovës i një norme kthimi prej 21.5 për qind është më e lartë se vlerësimet e planifikuara prej 18 për qind të bëra në vitin 2006.<sup>51</sup> Raportet e mëhershme të shtypit kishin deklaruar se Banka Botërore dhe ContourGlobal kishin një mosmarrëveshje në lidhje me normën e kthimit dhe zhvillimin tjetër.<sup>52</sup> Njoftimi i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik nënkupton se kjo mosmarrëveshje me Bankën Botërore është zgjidhur tani.

Pas gati 10 viteve të analizave, shkalla e kthimit të ekuitetit në këtë projekt është rritur, një shenjë e qartë e rrezikut të tregut. Rritja nga 18 për qind sa ka qenë fillimisht në supozimin më të ri të kthimit prej 21.5 për qind reflekton më shumë rrezik në projekt, e jo më pak.

Duke pasur parasysh konsideratat e rrezikut dhe pozitës shumë të pasigurt të ContourGlobal (përdorimi i borxhit për financimin e operacioneve), modeli financiar i IEEFA-s bën supozime agresive, një amortizimin të plotë pesëvjeçar në një normë prej 21.5 për qind të kthimit. Në përdorim këtë normë e kthimit në model me një opinion neutral/ negativ. IEEFA llogarit koston vjetore të projektin për ekuitetin si 43,49 EUR / MWh.

---

<sup>47</sup> Ibid.

<sup>48</sup> Moody's Investor Service, *Agreement at Maritsa subsidiary is credit positive*, April 9, 2015.

<sup>49</sup> Bloomberg Business, "Bulgaria Cuts Power Purchase Prices With AES, ContourGlobal," April 2015,

<http://www.bloomberg.com/news/articles/2015-04-08/bulgaria-cuts-power-purchase-prices-with-aes-contourglobal>

<sup>50</sup> <http://mzhe-ks.net/en/news/the-countrys-largest-project-tp-kosova-e-re-with-investments-exceeding-1-billion-and-thousands-of-jobs-gets-under-way-#.VmrksvIvIkp>

<sup>51</sup> LPTAP Dokumenti i Vlerësimit të Projektit, 2006, f. 77, [http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006\\_09\\_13](http://issuu.com/lptap/docs/lptap-project-appraisal-document-2006_09_13)

<sup>52</sup> Derisa dokumenti është këtu duke ndërtuar një model të Termocentralin Kosova e Re, është instruktive se shqetësimi i Bankës Botërore në lidhje me normën e kthimit është regjistruar. Banka Botërore, si një bashkë-huadhënës publik, me fuqinë e saj subvencionuese, në fakt ka përcaktuar kushtet me të cilat ContourGlobal merr pjesë në këtë projekt derisa vazhdojnë negociatat.

## D. Supozimet operative

### Kostot operative

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë fusha e tretë (përveç kostove të borxhit dhe ekuitetit) e nevojshme për të bërë një vlerësim të plotë të kostos së energjisë elektrike nga TCKR-ja. IEEFA përdor si pikënisje vlerësimet e kostos operative nga propozim buxheti 2015 i KEK-ut.<sup>53</sup> KEK-u operon me termocentralet me thëngjill Kosova A dhe Kosova B dhe të dhënat e saj të operacioneve paraqesin parashikimet më të mira në dispozicion për shpenzimet.<sup>54</sup> Kompania e vlerëson koston operative prej 28.93 EUR/ MWh për Kosovën A dhe B në vitin 2015. Kjo parashikon në të ardhmen një kosto operative të përshtatur për një inflacion prej 3 për qind në 33.53 euro/ MWh në 2021.

Struktura e pronësisë ose marrëveshja e menaxhimit për termocentralin nuk është përshkruar. Gjatë vitit të kaluar, ContourGlobal ka kërkuar që ajo të punojë në termocentral si pjesë e një marrëveshje partneriteti. Në përputhje me qëllimin e deklaruar të qeverisë për të privatizuar sistemin e saj të energjisë elektrike, IEEFA supozon një marrëveshje të re të biznesit duke përdorur një operator privat. Në përfshijmë në llogaritjet tona, si pjesë të buxhetit operativ, 21.25 euro/ MWh, si fitim që i paguhet menaxhuesit privat të termocentralit.<sup>55</sup>

IEEFA ka llogaritur koston e termocentralit me dhe pa kosto të karbonit. Është e paqartë nëse TCKR-ja do të përfshihet në kuadër të ndonjë prej protokolleve të karbonit të Bashkimit Evropian. "Përrjashtimet politike" të ndryshme që tashmë i janë bërë projektit ka të ngjarë të shtrihen edhe në rregulloret e karbonit (shih diskutimin në Faktori i Rrezikut Nr. 8). Me qëllim të përfshirjes së kostove të karbonit me një ndikim të vërtetë në buxhet, ne supozojmë shifrën prej 25.75 euro/ MWh.<sup>56</sup>

**Figura 4: Shpenzimet operative të Termocentralit Kosova e Re, viti i parë i operimit**

	Shuma (EUR / MWh)
Kostoja e operimit	33,53
Fitimi	21.25
Kostot e përgjithshme operative pa CO2	54,78
Vlerësimi i koston së CO2	25.75
Kostot e përgjithshme operative me CO2	80,53

<sup>53</sup> Korporata Energjetike e Kosovës, letër 2014, [http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni\\_i\\_KEK\\_ut\\_2015.pdf](http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KEK_ut_2015.pdf)

<sup>54</sup> Në prezantimin e Bankës Botërore 2011 vlerësuesit e saj parashikuan që një termocentral me linjit në vitin 2011 do të kushtonte 20.22 euro / MWh. Kjo do të jetë 27.16 EUR / MWh 3 për qind e përshtatjes së kostos për shkak të inflacionit në 2021.

<sup>55</sup> [http://www.cedelft.eu/publicatie/a\\_critical\\_examination\\_of\\_the\\_investment\\_proposals\\_for\\_unit\\_6\\_of\\_the\\_sostanj\\_power\\_plant/1205](http://www.cedelft.eu/publicatie/a_critical_examination_of_the_investment_proposals_for_unit_6_of_the_sostanj_power_plant/1205), shih fq. 9 për të buxhetin e detajuar të operacioneve duke përfshirë fitim neto prej rreth 16.5% të të hyrave dhe kostove të CO2.

<sup>56</sup> Shih:

[http://www.cedelft.eu/publicatie/a\\_critical\\_examination\\_of\\_the\\_investment\\_proposals\\_for\\_unit\\_6\\_of\\_the\\_sostanj\\_power\\_plant/1205](http://www.cedelft.eu/publicatie/a_critical_examination_of_the_investment_proposals_for_unit_6_of_the_sostanj_power_plant/1205), shih fq. 9 për zbatimin e standardeve të BE-së për buxhetet operative Šoštanj.

## Faktori i kapacitetit dhe parashikimet e kërkesës

Sasia e energjisë që mund të prodhohet nga një impiant quhet kapaciteti i termocentralit dhe matet në megavat (MW). *Termocentrali Kosova e Re* do të ketë një kapacitet prej 500 MW. Sepse 35 MW të kapacitetit janë të nevojshme për vet operimin e termocentralit, sasia e energjisë elektrike që është në dispozicion për rrjetin, i njohur si kapaciteti neto, do të jetë 465 MW.<sup>57</sup>

Përqindja e energjisë që prodhon një termocentral në krahasim me operacionet e saj maksimale prej 100 për qind njihet si "faktor i kapacitetit" të saj. Energjia e prodhuar nga një termocentral matet me megavat orë (MWh). Faktori i kapacitetit përcaktohet si nga ajo se sa mirë funksionon termocentrali ashtu edhe se sa energji elektrike nevojitet. Njoftimi i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik nuk ka dhënë asnjë informacion në lidhje me faktorin e kapacitetit për termocentralin. Në të kaluarën Banka Botërore ka përdorur 85 për qind si supozim operativ të saj.

Planifikuesit e projektit të *Termocentralit Kosova e Re* më përpara kanë supozuar se rritja vjetore e kërkesës për sistemin elektrik të vendit do të jetë 4.4 për qind. Planet gjithashtu parashikojnë një rritje më të përgjithshme të ekonomisë prej 4.5 për qind të Kosovës.

Këto supozime janë tepër optimiste (shih Faktori i Rrezikut Nr. 1). IEEFA bën këto supozime: 1) lajmërimi i zvogëlimit të madhësisë së termocentralit sugjeron pranimin se caktimi i mëhershëm i madhësisë së termocentralit ka qenë me të meta, pjesërisht për shkak se kërkesa e parashikuar nuk kishte gjasa të materializohet; 2) nga 2010-2014 konsumi i energjisë elektrike ishte i njëjtë apo pak negativ, dhe në kuadër të këtij trendi të përgjithshëm janë luhatjet e rëndësishme vjetore të kërkesës; 3) duke shkuar përpara IEEFA supozon një rritje vjetore të kërkesës prej 2.5 për qind duke përdorur si bazë kërkesën vjetore prej 5,375 GWh, një mesatare për pesë vitet e fundit.

Duke përdorur këto shifra, bashkë me kapacitetet përkatëse të Kosovës B dhe integrimin e kapaciteteve të tjera të planifikuara për furnizim me energji elektrike, IEEFA në modelin e saj përdor një faktor kapaciteti prej 75 për qind. Përdorimi i kësaj shifre bart një numër rreziqesh, duke përfshirë potencialin për shpenzime dukshëm më të larta të energjisë nga termocentrali nëse nuk materializohet rrija ekonomike dhe kërkesa. (Shih Seksioni mbi *Faktorët e Rrezikut*).

<sup>57</sup> Banka Botërore, Dokumenti për opsionet, 2011

**Figura 5: Faktori i kapacitetit**

Metrika përkatëse	Njësia matëse	Sasia
Kapaciteti i përgjithshëm - Termocentrali Kosova e Re	MW	500
Kapaciteti neto	MW	465
100% Faktori i kapacitetit	MWh	4,073,400
75% Faktori i kapacitetit	MWh	3,055,050
Rritja e kërkesës vjetore (2015-2025) <sup>58</sup>	MWh	2.5%

## E. Kostoja e përgjithshme e Termocentralit Kosova e Re

Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e mësipërm, IEEFA vlerëson se kostoja e sistemit të energjisë elektrike nga Termocentrali Kosova e Re në vitin 2021 do të jetë 128,17 EUR/ MWh, e përcaktuar si vijon:

**Figura 6: 2021 Kostoja e energjisë elektrike nga Termocentrali Kosova e Re**

Komponentët	Kostoja në EUR/ MWh
Kostoja e ekuitetit	43,49
Kostoja e borxhit	29,90
Kostoja e Operacioneve	54,78
Kostoja e energjisë elektrike pa CO2	128,17
Kostoja e energjisë elektrike me CO2	153,92

Kostoja e termocentralit<sup>59</sup> prej 128.17 EUR/ MWh është katër herë më e lartë se kostoja aktuale e energjisë elektrike në Kosovë, në sistemin e menaxhuar nga KEK-u. Kostoja për të prodhuar energji elektrike në sistemin e tanishëm ishte 28,93 \$ / MWh në vitin 2015, siç raportohet nga KEK-u. Sistemi aktual është i vjetër. Ajo drejtohet nga disa supozime të tjera të biznesit se sa ato të përdorura për TCKR-në. Për më tepër, edhe pse KEK-u ka ca borxhe në librat e vet (shih diskutimin Faktorët e Rrezikut nr 5) borxhi është menaxhuar në mënyrë fleksibile, duke përfshirë edhe shlyerjet e normës së interesit. Modeli i Termocentralit Kosova e Re do të bart fitim në operacione dhe kosto të konsiderueshme të borxhit dhe ekuitetit që do të duhet të paguhet.

<sup>58</sup> Shih diskutimin e trendeve të kaluara të kërkesës për energji elektrike në Kosovë, në krahasim me parashikimet e Bankës Botërore në Seksionin e Rrezikut: Faktori i Rrezikut # 1.

<sup>59</sup> Dokumenti për opsionet i Bankës Botërore (f.27) ka bartur një kosto të niveluar të energjisë elektrike për Termocentralin Kosova e Re (e njohur dikur si Termocentrali Kosova C) të 81.45 euro / MWh. Duke e përshtatur këtë shumë drejt vitit 2021 kostoja do të jetë 106,23 EUR / MWh. Kjo do të rezultojë në një rritje të përgjithshme prej 18.8% të çmimit të energjisë elektrike për familjet kosovare.

## F: Kostoja e vërtetë e termocentralit, përfshirë kostot e ndërtimit, pagesat e interesit dhe subvencionet

Ministri i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës deklaroi në nëntor se kostoja e ndërtimit të termocentralit do të jetë 1 miliard euro. IEEFA e konsideron këtë numër të dyshimtë dhe e ka ndryshuar atë në 1,35 miliardë euro, edhe pse ka të ngjarë që kostoja përfundimtare të jetë më e lartë. Një mënyrë tjetër për të shqyrtuar koston e termocentralit është që të shtohen kostot e ndërtimit, financimit dhe subvencionimit. Kjo jep një pasqyrë më të qartë se sa vërtet do të kushtoj termocentrali.

**Figura 7: Kostoja e përgjithshme e termocentralit përfshirë ndërtimin, financimin dhe subvencionimin (në euro)**

Artikull	Kosto
Kostoja e ndërtimit	1,355,000,000
Interesi për kredinë (7.5%)	882,085,000
Norma e kthimit të ekuitetit	259,249,000
Subvencionimi i jashtëm <sup>60</sup>	1,673,145,000
Kostoja totale e termocentralit në euro	4,169,479,000

Ministri i Zhvillimit Ekonomik nuk ka identifikuar as burimin e financimit për termocentralin e as burimin e ndonjë zotimi të subvencioneve, por me sa duket Banka Botërore do të jetë burimi kryesor i subvencioneve. Nëse Banka Botërore dhe burime të tjera zotohen për zbutjen e rritjes së çmimit të energjisë elektrike për shkak të termocentralit, ata do të duhet të ofrojnë subvencione më të mëdha se 1.7 miliardë euro të vlerësuara më lartë. Ndryshimi i normës së interesit në kredi në 2 për qind do të bëjë koston e energjisë elektrike më të përballeshme, por do të kërkonte një subvencion prej 2,3 miliardë eurosh për kohëzgjatjen e kredisë. Kjo do të rriste koston e vërtetë totale të termocentralit në 4,8 miliardë euro.

## Përmbledhje e Seksionit IV

Çmimi i termocentralit me thëngjill do të vendoste trysni të konsiderueshme për rritjen e çmimit të energjisë elektrike në Kosovë. Derisa kostoja e energjisë elektrike nga termocentrali do të jetë katër herë më e lartë se kostoja aktuale e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK-u, çmimi që u ngarkohet konsumatorëve mund të rritet deri në 50 për qind në vitin e parë të funksionimit.<sup>61</sup>

<sup>60</sup> Për të arritur një ulje të normës së interesit nga norma e tregut në 7.5% sa ka deklaruar Ministri i Zhvillimit Ekonomik ne vlerësojmë se do të kushtojë 1,673,145,000 EUR. Ne supozojmë një normë interesi të tregut prej 18% për kohëzgjatjen e kredisë për 20 vjet ose 2,555,230,000 euro.

<sup>61</sup> Për një shqyrtim të hollësishëm se si kostoja e energjisë elektrike nga termocentrali do të kthehet në rritje aktuale në faturat e konsumatorëve shih Shtojcën II.

IEEFA konstaton se kostoja e termocentralit, bazuar në të dhënat më të mira në dispozicion, është e jashtëzakonshme. Shtrohet pyetja nëse *Termocentrali i propozuar Kosova e Re* është mënyra më e mirë për të përdorur 4,169 miliardë euro.

IEEFA gjithashtu sheh fusha të konsiderueshme të rreziqeve të menjëhershme dhe të vazhdueshme për termocentralin nga ambienti i funksionimit financiar, afarist, politik dhe operativ të Kosovës. Këto rreziqe do të ndikojnë në funksionimin dhe financimin e termocentralit, në kostot e energjisë në Kosovë dhe në ekonominë e saj. Sepse furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike të përballueshme është nevojë themelore, dhe duke pasur parasysh se madhësia dhe rëndësia e termocentralit, rreziqet individuale dhe kumulative që lidhen me *Termocentralin Kosova e Re* janë rreziqe edhe për interesin publik.

## V. Faktorët e rrezikut me të cilët përballet termocentrali i propozuar, sistemi i energjisë elektrike të Kosovës dhe ekonomia e saj

Mjedisi në të cilin do të ndërtohet dhe operojë *Termocentrali Kosova e Re* përmban rreziqe të shumta. Marrë individualisht dhe në mënyrë kumulative, këto rreziqe paraqesin sfida të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të këtij projekti si një burim të energjisë të përballueshme. Ky seksion i raportit IEEFA përshkruan këto rreziqe dhe tregon për mundësinë që ato të ndodhin. Kur është e nevojshme, ky seksion gjithashtu identifikon se si një faktor specifik i rrezikut mund të ndikojë në konkluzionet sasiore të paraqitura në modelin e zhvilluar për këtë raport.

**FAKTORI I RREZIKUT NR. 1:** Rritja ekonomike mund të mos zhvillohet në nivele të mjaftueshme dhe me ekuitet të mjaftueshëm të shpërndarjes për të mbështetur *Termocentralin Kosova e Re* dhe kërkesat e reja të financimit të saj.

Parashikimet e Bankës Botërore për Kosovën supozojnë se produkti i brendshëm bruto i Kosovës do të rritet me 4.5 për qind në vit deri në vitin 2025.<sup>62</sup> Megjithatë, nga viti 2010 ekonomia e Kosovës i është afruar kësaj norme të rritjes vetëm një herë, në vitin 2011 me një rritje 4.4 prej qind. Nga viti 2010 deri në vitin 2014 norma mesatare e rritjes së PBB-së ishte ndjeshëm më e ulët se 4.5 për qind dhe norma ka gjasa të mbetet nën 4.5 për qind në vitin 2016 dhe 2017.<sup>63</sup> Fondi Monetar Ndërkombëtar kohëve të fundit ka parashikuar në normë vjetore të PBB-së në Kosovë


<sup>62</sup> Banka Botërore, "Dokument për sfondin: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve të furnizimit me energji për Kosovën", 2011 f. 13, [http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo\\_generation\\_options\\_report\\_12312011.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo_generation_options_report_12312011.pdf)

<sup>63</sup> Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, Kosovë, <http://wiiw.ac.at/kosovo-overview-ce-23.html>



deri në vitin 2020 në 3.9 për qind.<sup>64</sup> Ndërsa njoftimi i fundit i qeverisë për *Termocentralin Kosova e Re* tani i referohet një termocentrali prej 500 MW dhe një zvogëlim prej 16.6 për qind të madhësinë e termocentralit, madje as kjo mund të mos jetë e nevojshme.

**Figura 8: Krahasimi i prodhimit real të Kosovës 2004-2014 me parashikimet e Bankës Botërore të 2011 për vitet nga 2010 deri në 2025 në GWh**



Një krahasim i prodhimit faktik të raportuar të Kosovës për periudhën 2004-2014 krahasuar me parashikimet e Bankës Botërore të vitit 2011 Studimi i Opsioneve për prodhimin dhe konsumin tregon se Banka Botërore ka mbivlerësuar konsumin e energjisë elektrike për periudhën 2010-2014 për një mesatare prej 14 për qind në vit. Gjatë periudhës pesëvjeçare për të cilat janë në dispozicion të dhënat, shpërndarja midis prodhimit faktik dhe të parashikuar është rritur në sasi më të mëdha në vitet tre deri në pesë sesa në vitet një dhe dy.

Nëse ekonomia nuk rritet siç është parashikuar, kërkesa për energji elektrike nuk do të jetë aq e madhe sa është parashikuar. Kjo mund të zvogëlojë shfrytëzimin e *Termocentralit Kosova e Re* (ose ndonjë komponenti tjetër të sistemit elektroenergjetik të Kosovës), duke shkaktuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike nga termocentrali, pasi që kostot e larta fikse të termocentralit do të shpërndahen në më pak megavat të prodhuara. Një reduktim i faktorit të kapacitetit të termocentralit nga niveli i planifikuar prej 75 për qind i përdorur në këtë raport në 60 për qind, për shembull, do të shkaktonte një rritje të konsiderueshme të çmimit në atë që tashmë është parashikuar në këtë raport.

Duke shkuar përpara, qeverisë së Kosovës do t'i shërbente mirë nga një model i besueshëm dhe në dispozicion publik i të dhënave për energjinë elektrike që mat konsumin, kërkesën dhe ofertën në bazë të njëjtë me kalimin e kohës.


<sup>64</sup> Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Republika e Kosovës, Raporti për vendin, Nr 15/210, Korrik 2015, <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2015/cr15210.pdf>

**FAKTORI I RREZIKUT NR. 2:** Kostoja e termocentralit do të shkaktoj tension në sektorin bankar dhe financiar që do të minojë llojin, cilësinë dhe shkallën e rritjes ekonomike që tani ndodh në Kosovë.

Termocentrali paraqet një numër të rreziqeve për situatën makro financiare të vendit.

Figura 9 më poshtë tregon se bankat komerciale të Kosovës kishin 2,6 miliard \$ depozita në fund të vitit 2014. Raporti i tyre kredi -depozita ishte rreth 76 për qind, por ka rënë në 81 për qind nga shkurti 2015.<sup>65</sup>

**Figura 9: Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale të Kosovës: Dhjetor 2009-Shkurt 2015<sup>66</sup>**



Burimi: Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyrë e vendit, prill 2015," Figura 3.

Shtimi termocentrali të ri të Kosovës në nivelet e kredive komerciale të institucioneve bankare të Kosovës do të rrisë nivelet e kredisë nga € 2,08 miliardë në € 3,0 miliardë, duke e çuar raportin kredi - depozita në mbi 100 për qind. Ky transaksion do të rris rrezikun makroekonomik për vendin. Së pari, ai do të përqendrojë rrezikun në një ekonomi që është e vogël dhe tashmë është duke u përballur me diversifikimin e rrezikut. Së dyti, ajo do të tejkalojë standardin e vendosur nga ekzaminues të pavarur bankarë për mbajtjen e

<sup>65</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e Vendet, prill 2015," <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

<sup>66</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e Vendet, prill 2015," p. 4, <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

raportit kredi - depozita në 80 për qind.<sup>67</sup> Së treti, ajo do të shtojë tensionet politike në vend për një sërë çështjesh që lidhen me sektorin bankar vendas dhe të huaj.<sup>68</sup> Së katërti, kjo ka gjasa që të vendos kufizime kreditore në sektorë të tjerë në një kohë kur ekonomia private është në gjendje të rëndë; sipas Bankës Botërore, modeli aktual i rritjes ekonomike për zhvillimin privat në Kosovë është tashmë i paqëndrueshëm.<sup>69</sup>

Skenarët e mundshëm të paraqitur deri më tani lidhur me strukturën e kredisë, duke përfshirë edhe një subvencion të normës së interesit nga një konsorcium i huadhënësve publikë dhe privatë, do të vendoste nën një presion afatgjatë ekonominë e Kosovës për të shlyer një borxh masiv.

## Shpërndarjet tipike ndërmjet normave mesatare të kreditimit, kreditimit për ekonomi familjare dhe kreditimit të ndërmarrjeve

Historikisht, bankat në Kosovë u japin para hua bizneseve me një normë interesi më të lartë se që u japin ekonomive familjare, duke pasqyruar një profil më të lartë të rrezikut të kreditimit komercial. Për shembull, "Norma mesatare e interesit në kredi (për një mesatare 12-mujore) që nga qershori i vitit 2010 ishte 14.3 për qind, ku norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve ishte 16.7 për qind, ndërsa mesatarja për kreditë e ekonomive familjare ishte 12.2 për qind".<sup>70</sup> Në këtë shembull, diferenca midis normës mesatare të interesit dhe normës komerciale ishte 2.4 për qind. Në mjedisin e tanishëm ekonomik normat e interesit të Kosovës kanë rënë dhe janë pak nën 10 për qind. *Termocentrali Kosova e Re* do të vendosë presion për rritjen e normave të interesit në një kohë kur është bërë progres drejt uljes së tyre. Norma e interesit të kredisë së projektit e cekur nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik për një kredi të kësaj madhësie është e paqëndrueshme nëse mungon subvencionimi masiv.

Një kredi e subvencionuar masivisht, duke përdorur një projekt me vetëm një ofertues të bazuar në 'përjashtimet politike' nga politikat dhe një sistem të dobët të shërbimeve nuk do të jetë një paketë tërheqëse për komunitetin bankar ndërkombëtar. Ka më shumë gjasa që natyra me rrezik të lartë e transaksionit do të dëmtojë historinë më pozitive të rritjes së progresit modest por të qëndrueshëm që po ndodh në ekonomi.


<sup>67</sup> <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2013/cr1399.pdf>, p. 22.

<sup>68</sup> Për një diskutim të çështjeve kyçe makro-financiare me te cilat përballet sistemi bankar i Kosovës shih: Fondi Monetar Ndërkombëtar, "Republika e Kosovës: Vlerësimi stabilitetit të sistemit financiar", Raporti i FMN për Vendin Nr 13/99, prill 2013 <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2013/cr1399.pdf>

<sup>69</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e Vendit, prill 2015," p. 5, <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

<sup>70</sup> Normat e interesit nga bankat në Kosovë, Analize krahasuese - në mes të Kosovës dhe vendeve fqinje, Përgatitur nga: XHEVAT Meha FCCA Prishtinë, shtator 2011, f. 5 [http://www.luani.net/publikimet-artikujt-65/items/interest-rates-by-banks-in-kosovo.html?file=tl\\_files/music\\_academy/Interest%20rates%20on%20bank%20lending%20in%20Kosovo.pdf](http://www.luani.net/publikimet-artikujt-65/items/interest-rates-by-banks-in-kosovo.html?file=tl_files/music_academy/Interest%20rates%20on%20bank%20lending%20in%20Kosovo.pdf)

**Figura 10: Normat mesatare të interesit në Kosovë: 2008-2014<sup>71</sup>**



Burimi: Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e Vendit, prill 2015," Figura 4.

## Përmirësimet që nevojiten për sistemin e huadhënies bankare në Kosovë

Në Kosovë veprojnë tetë banka komerciale. Dy janë banka vendore; pjesa tjetër janë ose të bazuara në Evropë ose filiale kosovare të bankave amë evropiane në Gjermani, Slloveni, Austri, Turqi dhe Shqipëri. Sektori bankar në mënyrë tipike i mbulon nevojat e saj të kreditimit nëpërmjet depozitave bankare nga familjet dhe bizneset në Kosovë.<sup>72</sup>

Vëzhguesit e sistemit bankar të Kosovës që përfshijnë Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim<sup>73</sup> dhe Projektet e Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur<sup>74</sup> kanë treguar se sistemi ka nevojë për kreditim më të madh të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.<sup>75</sup> Mikro kreditimi shihet si një çelës për rritjen në ekonomi.<sup>76</sup>

Projekti i TCKR-së është një kredi e vetme e jashtëzakonshme që do të kërkojë të paguhet nga një vend me një treg të ulët të pagave dhe një portofol të investimeve që janë të vogla dhe që përballen me vështirësi.

## Mungesa e mbështetjes bankare vendore; thëngjilli dhe rreziqet e normave të interesit

Një kredi e madhe si kjo e parashikuar për *Termocentralin Kosova e Re* do të kërkojë përfshirjen e një konsorciumi të bankave. Termocentralet me thëngjill shihen si investime me rrezik të lartë

<sup>71</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, "Pasqyra e Vendit, prill 2015," f. 4.

<http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

<sup>72</sup> Shoqata e Bankave të Kosovës, "Studim krahasues mbi mjedisin e biznesit dhe roli i sektorit bankar në Kosovë" Slajdi7, <http://bankassoc-kos.com/wp-content/uploads/2013/09/KBA-Research-Study-final.pdf>,

<sup>73</sup> OECD, Enterprise Development and Innovation Facility (EDIF), <http://www.oecd.org/investmentcompact/enterprise-development-innovation-western-balkans.htm>

<sup>74</sup> Instituti Riinvest, "Seksioni bankar: Lehtësues apo pengues", <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/53.pdf>

<sup>75</sup> Qendra për Hululumtim, "Normat e interesit në sistemin bankar të Kosovës" <http://cn4hs.org/wp-content/uploads/2015/09/CRDP-Chronicle-Interest-Rates-in-Kosovo-August-31-2015.pdf>

<sup>76</sup> Shoqata e Bankave të Kosovës, "Studim krahasues mbi mjedisin e biznesit dhe roli i sektorit bankar në Kosovë" <http://bankassoc-kos.com/wp-content/uploads/2013/09/KBA-Research-Study-final.pdf>

për shkak të kostove të tyre të ndërtimit, kostove mjedisore, rrezikshmërisë nga konkurrenca, rrezikut të politikave, rrezikut potencial klimatik dhe rritjes së kundërshtimit publik.<sup>77</sup> Gjatë 10 viteve të fundit Qeveria e Kosovës ka dështuar të krijojë një konsorcium privat të kreditimit që është i gatshëm të absorbojë këtë rrezik. Ajo nuk ka identifikuar ndonjë grup të huadhënësve në deklaratat e saj më të fundit. Koordinimi i politikave për një konsorcium të kreditimit lidhur me thëngjillin, veçanërisht lidhur me krijimin e një norme interesi që i përgjigjet rrezikut, ka të ngjarë të jetë problematike.<sup>78</sup>

## Rreziku politik

Siç u diskutua më herët në këtë raport, planet për *Termocentralin Kosova e Re* kanë ndryshuar disa herë, qoftë si rezultat i supozimeve të vlefshme të energjisë të lidhura me planifikimin ashtu edhe për shkak të zgjedhjeve të vlerave të nxitura nga ngjarjet politike. Këto ndryshime politike ndodhin ndoshta më shpesh në jetën e një vendi të ri se në një mjedis më stabil dhe të qëndrueshëm.

*Ekonomika e Termocentralit Kosova e Re, nëse do të subvencionohet kostoja nga jashtë, do të paraqes zgjedhje të vazhdueshme politike për qeverinë e Kosovës. Pjesa më e madhe e këtyre zgjedhjeve do të sillen rreth çështjes së normave të energjisë elektrike dhe presionit për rritjen e tyre që do e bëjë termocentrali mbi to. Këta faktorë nuk mund të injorohen kur përcaktohet norma e interesit për këtë projekt.*

Një shembull i kohëve të fundit nga Bullgaria, ku përfshihet ContourGlobal, zhvilluesi i njëjtë i cili planifikon të përfshihen në TCKR, tregon se edhe pasi termocentrali të ndërtohet dhe të fillojë së funksionuari presioni politik mund të detyrojë një ristrukturim të financave të projektit dhe rritjen e rrezikut për investitorët.<sup>79</sup> Në raste të tilla, zhvilluesi merr një kthim shumë më të ulët të investimeve të tij se ajo që e kishte planifikuar.

Asnjë nga dokumentet teknike të porositura nga Banka Botërore dhe të tjerët për këtë projekt nuk kanë adresuar ndikimin e projektit në sistemin bankar apo në normat aktuale të interesit në vend. *Termocentrali Kosova e Re* do të kërkojë një kredi të madhe në një treg relativisht të vogël financiar. Kredia do të përcaktojë vendimet bankare të Kosovës për dekadat e ardhshme. Zakonisht kreditë e kësaj natyre janë kredi "jashtë bilancit të kompanisë", por struktura e kredisë në këtë rast është e rregulluar në mënyrë që pagesat e ekuitetit, fitimet dhe pagesat e kredisë do të rishfaqen në "pasqyrat e bilancit" të banorëve dhe bizneseve të Kosovës në tarifat e reja me të cilat do të ngarkohen ato.

Norma e interesit prej 7.5 për qind e cituar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik do të bazohet në një subvencionim të madh. Modeli IEEFA-s sugjeron se projekti do të mbetet financiarisht i rrezikshëm

<sup>77</sup> Froggatt, A., "Coal Financing in Europe: The Banker's Dilemma," 2011, [https://www.chathamhouse.org/sites/files/chathamhouse/public/Research/Energy,%20Environment%20and%20Development/1111pp\\_froggatt.pdf](https://www.chathamhouse.org/sites/files/chathamhouse/public/Research/Energy,%20Environment%20and%20Development/1111pp_froggatt.pdf)

<sup>78</sup> Për shembull, në vitin 2008, një agjenci e qeverisë së Shteteve të Bashkuara me përvojë 70 vjeçare në financimin e termocentraleve me qymyr, filloi të vlerësojë rrezikun nga termocentralet e reja me djegie të thëngjillit në një treg që ndryshon. Pas shqyrtimit të tregjeve të ndërtimit, tregjeve të qymyrit dhe ndryshimeve të mundshme në politikën e ardhshme të karbonit, agjencia vendosi se rreziqet kumulative e bën krijimin e normës së interesi që reflekton me saktësi rrezikun nga termocentralet me thëngjill shumë spekulativ. Agjencia që nga viti 2008 nuk ka financuar ndonjë termocentral të ri me thëngjill. Mail Tribune ", USDA e ndalon programin e kredisë për impiantet rurale me thëngjill," <http://www.mailtribune.com/article/20080314/BIZ/803140318>

<sup>79</sup> Reuters, "Bullgaria aprovon marrëveshjen për uljen e çmimit të rrymës me ContourGlobal," <http://www.reuters.com/article/2015/08/27/bulgaria-energy-idUSL5N1122SP20150827>

dhe do të prodhojë energji elektrike që është e papërballueshme edhe me financimin prej 7.5 për qind. Çmimi i energjisë elektrike do të rritet më shumë seç parashihet në këtë studim përveç nëse bëhen subvencionime të mëtejshme ose nëse ContourGlobal e ul më shumë normën e saj të kthimit.

**FAKTORI I RREZIKUT NR. 3:** Tani kandidatë të rinj të sektorit privat që hyjnë në sistemin e energjisë elektrike në Kosovë nuk kanë të njëjtat interesa si Qeveria e Kosovës. Qeveria e Kosovës nuk ka demonstruar kapacitete të mjaftueshme për të siguruar kushtet e një marrëveshjeje reciprokisht të dobishme ose për të arritur llogaridhënien afatgjate për të mirën e popullit të Kosovës.

Investitorëve privatë dhe çdo operatori të ri privat që hyn në sistemin energjetik të Kosovës nëpërmjet *projektit të Termocentralit Kosova e Re* do tu kërkohet respektimi i kontratave dhe orareve të pagesave dhe ata do të paraqesin kërkesa të tjera për qeverinë e Kosovës. Qeveria e Kosovës ka një histori të ndërhyrjes politike në funksionimin e bizneseve të veta shtetërore.<sup>80</sup> Çrregullimi politik në modelin e ri të biznesit është një rrezik si për qeverinë ashtu edhe për çdo kompani të re private që bën biznes në Kosovë. Ri-negocimi i kohëve të fundit i kostove të termocentralit Maritsa në Bullgari dhe tejkalimi i kostove dhe hetimet për korrupsion që lidhen me termocentralin Šoštanj 6 në Slloveni janë shembuj të kohëve të fundit se si këto reziqe mund të materializohen.

Njoftimi i fundit i Qeverisë së Kosovës që identifikon ContourGlobal si zhvilluesin e preferuar për projektin nuk u shoqërua me ndonjë informacion në lidhje me modelin e biznesit dhe strukturën ligjore të projektit të *Termocentralit Kosova e Re*. IEEFA supozon se do të ketë një formë të partneritetit publiko-privat e ngjashme me marrëveshjen e privatizimit Limak-Çalik për sistemin e transmisionit dhe të shpërndarjes së Kosovës.<sup>81</sup>

Një partneritet publiko-privat (PPP) është kontratë ndërmjet një qeverie dhe një kompanie private. Për të pasur sukses, marrëveshjet publike-private duhet të jenë reciprokisht të dobishme.

Në mënyrë tipike, kompania private financon, ndërton dhe operon disa elemente të një shërbimi publik, në këtë rast të *Termocentralit Kosova e Re*. Kompania private paguhet për një numër vitesh, ose nëpërmjet ngarkesave të konsumatorëve ose nga pagesat nga qeveria, ose një kombinim i të dyjave. Për publikun, këto transaksione mund të sigurojnë financimin dhe ekspertizën private. Projektet në masë të madhe janë kundërthënëse për shkak se ato përfshijnë projekte të mëdha publike, si TCKR.

Partneriteti publiko-privat për TCKR përmban tri lloje kryesore të rrezikut: 1) modeli i PPP natyrisht ka gjasa të rezultojë në kosto më të larta të ndërtimit dhe operative sesa ato të supozuara në modelin e IEEFA-s në këtë raport; 2) modeli i PPP-së do të futë faktorë të ri të shpenzimeve në funksionimin e vazhdueshëm të termocentralit të cilët do të bëjnë trysni të vazhdueshme për

<sup>80</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, "Deklarata për Klimën e Investimeve 2014," qershor 2014, <http://www.state.gov/documents/organization/229098.pdf>

<sup>81</sup> <http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/06/4.-KEDS-PRIVATISATION-IN-THE-ENERGY-SECTOR.pdf>

ritjen e çmimeve të energjisë elektrike në Kosovë; 3) modeli i PPP do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme qeverisjen aktuale të sistemit të energjisë elektrike, një faktor me implikime të rëndësishme për fuqinë punëtore të Kosovës të punësuar aktualisht, si dhe për mundësitë e ardhshme të punësimit.

Kundërshtarët<sup>82</sup>dhe ithtarët<sup>83</sup>e partneriteteve publike-private, si dhe udhëzimet neutrale të palëve të treta,<sup>84</sup>theksojnë se planifikimi shëndoshë, një ekip i aftë negociues i sektorit publik, këshillat e mira financiare dhe transparenca janë elemente kritike të suksesit.<sup>85</sup>

Një përmbledhje e literaturës mbi PPP-të dhe përvojës profesionale të analistëve të IEEFA nxjerrë në pah çështjet e përbashkëta dhe fushat e rrezikut, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat:

1. Objektivat dhe prioritetet: A ekzistojnë objektiva dhe prioritetet të qarta të sektorit publik, të përshkruara në legjislacionin gjithëpërfshirës të projektuara për të informuar zhvillimin, veprimet dhe fazat e vlerësimit të projektit?
2. Energjia e shëndoshë dhe planifikimi financiar: A janë marrë në konsideratë mundësitë alternative të energjisë? Cilat janë supozimet bazë të opsioneve; a janë vlerësuar opsionet krahasuar me modelet e ndryshme të biznesit?A ka objektiva dhe metoda të qarta lidhur me përfitimet financiare?
3. Politikat qeveritare për kontratën: A ka pasur tender konkurrues kundrejt shitjeve të negociuara?A kanë profesionistët e prokurimit të sektorit publik aftësi dhe njohuri për të vlerësuar propozimet?
4. Llogaridhënia dhe cilësia e këshillave financiare dhe konsulentëve: Kujt i shërbejnë ato? Sa të hollësishme janë ato?Çfarë është e përvoja e kaluar e qeverisë nikoqire në menaxhimin e konsulentëve?
5. Planet e biznesit: A ka plan të biznesit për qeverinë?Cilët janë personat juridikë që qeverisin fazat e zhvillimit dhe operimit, çfarë është struktura e marrëveshjeve ligjore që përbëjnë dokumentet qeverisëse; cilat janë linjat e autoritetit dhe komunikimit; sa janë mbledhur, llogaritur dhe shpërndarë të ardhurat; cilat janë termat dhe kushtet e kontratave kritike; a ka buxhete të zhvillimit, buxhete të operimit me arsyetimet dhe shpjegimet dhe a janë në dispozicion të publikut; a janë këto buxhete udhëzuese apo ligjërish të zbatueshme; a ka orare të pagesës për të gjitha palët?
6. Tarifat dhe subvencionet publike: a ka ndonjë plan të qartë se sa do të paguajë publiku para, gjatë dhe pasi të jetë përmbytur transaksioni?A janë përshkruar në mënyrë të qartë subvencionet publike dhe a u janë sqaruar të dy çështjet publikut dhe organeve drejtuese të qeverisë para transaksionit?

<sup>82</sup> <http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/06/4.-KEDS-PRIVATISATION-IN-THE-ENERGY-SECTOR.pdf>

<sup>83</sup> <http://www.ncppp.org/wp-content/uploads/2013/03/WhitePaper2012-FinalWeb.pdf> , Shih po ashtu:

[http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/e00cbd004e4adc988f0caf7a9dd66321/PPPStories\\_Kosovo\\_ElectricityDistribution.pdf?MOD=AJPERES](http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/e00cbd004e4adc988f0caf7a9dd66321/PPPStories_Kosovo_ElectricityDistribution.pdf?MOD=AJPERES)

<sup>84</sup> [http://www.cscd.gov.bc.ca/lgd/policy\\_research/library/public\\_private\\_partnerships.pdf](http://www.cscd.gov.bc.ca/lgd/policy_research/library/public_private_partnerships.pdf)

<sup>85</sup> Banka Botërore gjithashtu ofron një seri e udhëzimeve në rrugë të detajuara për përdorimin e partneritetit publik-privat dhe implikimet e ndryshme ligjore, financiare dhe qeveritare. <http://ppp.worldbank.org/public-private-partnership/overview/ppp-objectives#risks>

7. Kontrollat e brendshme: A është qeveria e përgatitur për të mbrojtur veten dhe për të siguruar përfitime gjatë zbatimit? Cilat standarde do të përdorë qeveria të përcaktojë nëse përfitimet e premtuara janë përfitimet e pranuar?

8. Politikat e punës: Si do të marrin vendet e punës që janë premtuar gjatë ndërtimit njerëzit që banojnë në vendin nikoqir? Cilat do të jenë standardet e punës, duke përfshirë pagat dhe përfitimet, për projektin e ndërtimit? Si do të mbahen punonjësit aktualë të cilët ofrojnë shërbimet aktuale pasi të jetë përfunduar transaksioni, dhe çfarë do të jetë paketa e kompensimit për këta punonjës? Në çfarë grupi të fuqisë punëtore do të mbështeten për rekrutimin e punonjësve të ri dhe çfarë do të jetë paketa e tyre e kompensimit?

9. Mbikëqyrja dhe masat korigjuese: Çfarë ndodh nëse rezultatet aktuale nuk do të përputhen me performancën e planifikuar? Çfarë monitorimi formal bëhet që dokumenton dhe verifikon performancën sipas marrëveshjeve? Çfarë lloj i planifikimit të veprimit korigjues ekziston?

10. Politika: A posedon organi qeveritar nivelin e stabilitetit të brendshëm, përkushtimin dhe ekspertizën si për të bërë marrëveshjen ashtu edhe për të realizuar përfitimet?

Bazuar në kriteret e mësipërme, shqyrtimi nga IEEFA i procesit të planifikimit të *Termocentralit Kosova e Re* gjen një numër shenjash paralajmëruese të rëndësishme që tregojnë se qeveria e Kosovës është një partner i dobët për të lëvizur përpara me këto negociata.

Ndër këto shenja paralajmëruese:

1. Studimet e fundit të planifikimit dhe financave kanë vlerësuar gabimisht elementet bazë të kërkesës për energji dhe opsionet e energjisë për Kosovën dhe kanë dështuar të nxjerrin në pah çështjet e kapaciteteve shumë të dobëta organizative.

2. Ekipi zhvillimor i mbledhur nga qeveria e Kosovës ka treguar performancë të dobët. Ekipi ka dështuar për më shumë se një dekadë që të bëjë bashkë komponentët e ndryshme të një projekti ekonomikisht të qëndrueshëm. Një faktor tërësisht brenda kontrollit të ekipit zhvillimor është niveli i kërkesës për energji dhe madhësia dhe projekti i termocentralit me thëngjill që do të përdoret. Kjo mbetet një çështje e diskutueshme edhe 10 vjet pas fillimit të planifikimit të projektit. Dobësitë tjera të demonstrueshme përfshijnë edhe atë se projekti nuk ka sjell një ofertë të vlefshme konkurruese. As nuk ka prodhuar ndonjë investitorë të identifikueshëm të sektorit privat.

3. Në të gjitha studimet e planifikimit dhe marrëveshjet me konsulentë, nuk është vënë në dispozicion të publikut asnjë plan biznesi që mund të përdoret për të bërë përcaktime përfundimtare të realizueshmërisë të projektit dhe për të monitoruar ndryshimet. Tema kryesore e këtij studimi, për shembull, sa do të paguajë populli i Kosovës për energji elektrike nëse ndërtohet *Termocentrali Kosova e Re* – as që është ngritur me herët.

4. Përvoja e mëhershme e qeverisë së Kosovës me privatizimin është e panjohur. Nuk ka pasur asnjë raportim të besueshëm publik mbi marrëveshjen apo progresin e privatizimit të



transmisionit. Në fakt, krejt e kundërta. Përprojekjet për të marrë informacionet e vlefshme për të bërë vlerësimin e jashtëm nuk hasin në bashkëpunimin e qeverisë.<sup>86</sup>

5. Ndryshimet e ndryshme substanciale të projektit gjatë dekadës së fundit reflektojnë edhe mbështetjen e dobët teknike edhe ndërhyrjet e konsiderueshme politike. Shqyrtimi ynë tregon se forma kryesore e menaxhimit të këtij projekti deri tani ka qenë politike dhe jo kompetente profesionale dhe se ai nuk udhëhiqet me politika financiarisht të shëndosha energjetike për përfitim të përgjithshëm të Kosovës. Mbështetja e jashtme politike për këtë projekt është bazuar në "përgjithshmet politike" në politikat dhe standardet financiare, një bazë vërtetë e dobët për procedim.

6. Pohimi nga zhvilluesi i projektit ContourGlobal se ndërtimi i termocentralit do të krijonte 10,000 vende pune<sup>87</sup> nuk është mbështetur nga ndonjë studim i besueshëm,<sup>88</sup> dhe nuk ka asnjë garanci se kosovarët do të marrin ndonjë nga vendet e punës që do të krijohen.<sup>89</sup> Nëse ndërtohet termocentrali, një plan do të duhet të miratohet për të siguruar që çdo vend pune i krijuar do të jetë për kosovarët.

Përkrahësit,<sup>90</sup> kundërshtarët dhe vëzhguesit nga palët e treta, të gjithë theksojnë kujdesin e duhur dhe profesional për shkak se një partner i dobët në fund të fundit do të krijojë një projekt të dobët. Në këtë rast, dobësitë në qeverinë e Kosovës ka të ngjarë të shfrytëzohen nga zhvilluesi privat në një mënyrë që do të shkaktonte rritjen e subvencioneve dhe që publiku i Kosovës të paguajë çmime më të larta për energji elektrike. IEEFA nuk e sheh këtë si një rrezik të largët. Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të projektit, ne e shohim atë si gjithçka tjetër përveç se rezultat të qartë.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 4: Plani i shpallur financiar për këtë termocentral është i bazuar në një raport 70 për qind borxh dhe 30 për qind ekuitet (kapital). Kosova nuk ka përvojë të kaluar me këtë lloj të strukturës financiare.**

Sipas sistemit aktual, qeveria e Kosovës është pronare 100 për qind e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Qeveria i jep para hua KEK-ut me një normë interesi prej 2 për qind për 30 vjet.<sup>91</sup>

<sup>86</sup> <http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/06/4.-KEDS-PRIVATISATION-IN-THE-ENERGY-SECTOR.pdf>

<sup>87</sup> <http://www.reuters.com/article/kosovo-energy-contourglobal-idUSL6N0VE2DW20150204>

<sup>88</sup> Qendra për Studime Ochs Metropolitane ka kryer një studim në vitin 2011 për të përcaktuar nëse termocentralet e thëngjillit në SHBA nga 2005-2009 i kishin arritur objektivat e tyre për krijimin e vendeve të punës, dhe arriti në përfundimin se projektet nuk ishin as afër arritjes së atyre objektivave: [http://www.huffingtonpost.com/david-eichenthal/coal-doesnt-deliver-on-it\\_b\\_846641.html](http://www.huffingtonpost.com/david-eichenthal/coal-doesnt-deliver-on-it_b_846641.html)

<sup>89</sup> Shumë pak studime janë bërë nga Banka Botërore apo analistë të tjerë për krijimin e vendeve të punës nga projektet e financuara me marrëveshje PPP. Komunitetet në Shtetet e Bashkuara megjithatë, kanë bërë fushatë për dekada të tëra për të siguruar se punët e premtuara për banorët lokalë t'i jepen banorëve lokalë. Zakonisht është e vështirë për të përkthyer premtimet aktuale në vende pune. <http://www.forworkingfamilies.org/sites/pwf/files/publications/0708-MakingDevelopmentWorkForLocalResidents-Summary.pdf>

<sup>90</sup> Raporti i TCKR ofron gjashtë shembuj të transaksioneve të suksesshme të privatizimit. IEEFA vë në dukje se asnjë nga shembujt e përdorur nuk janë termocentrale. <http://www.ncppp.org/wp-content/uploads/2013/03/WhitePaper2012-FinalWeb.pdf>

<sup>91</sup> GrantThornton, "Independent Auditors' Report and Financial Statements Kosovo Energy Corp., fundvit 31 dhjetor 2014," f. 26 dhe 35, <http://www.kek-energy.com/doc/publikime/Grant%20Thornton%20Financial%20Statement%20for%20year%20ended%2031%20December%202014.pdf>

KEK-u dhe qeveria kanë një shkallë të lartë të fleksibilitetit për kushtet dhe pagesat. Për shembull, pagesat e interesit të KEK-ut janë shlyer kohët e fundit.

Sipas marrëveshjes së shpallur nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, të paktën dy dhe me siguri më shumë investitorë do të japin para për termocentralin. Sistemit të energjisë elektrike, si pasojë, do t'i duhet të bart nivele dukshëm më të larta të borxhit, me norma më të larta interesi, me afate të shkurtra të pagesës dhe dispozita në rast të mospërmbushjes së obligimeve. Mos respektimi i këtyre afateve do të krijonte rreziqe të menjëhershme për pronarin e kapitalit (ekuitetit) dhe ngrejë çështje të rëndësishme për huadhënësit e tjerë.

ZRRE ka identifikuar forma të ndryshme të humbjeve të energjisë në sistemin elektrik të Kosovës, si dhe vështirësi në faturimin dhe inkasimin e të hyrave të pambledhura.<sup>92</sup> Nivelet e humbjeve faktike monetare janë të konsiderueshme. Ndërsa tani është arritur njëfarë progresi, çështjet e humbjeve të energjisë, faturimit dhe arkëtimit - të gjitha pengojnë krijimin e një rrjedhe të përshtatshme, dhe stabile të parasë. Rrjedha e parashikueshme e parasë është e nevojshme për projektin e propozuar të TCKR-së, dhe çdo çrregullim në rrjedhën e parasë paraqet rrezik.

Kompanitë private punojnë me premisën se çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët ka lidhje të ngushtë me koston e prodhimit, pagimit të borxhit dhe fitimit. Nëse TCKR ndërtohet ashtu siç është planifikuar, kompanitë private ka të ngjarë të jetë ithtarë aktivë të normave më të larta të energjisë elektrike. Presioni për të rritur çmimin e energjisë elektrike tashmë është problem në Kosovë në sistemin aktual rregullator. Shtimi i pronarëve dhe investitorëve të huaj do të paraqes rrezik të shtuar që çmimi i energjisë elektrike në Kosovë do të bart barrën e normave të interesit të atyre kompanive, kredisë dhe rreziqet e tjera financiare.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 5: Termocentrali Kosova e Re do të rezultojë në devijim të pjesëve të rëndësishme të të hyrave aktualisht në dispozicion të qeverisë së Kosovës dhe organizatave të saj vartëse, më së shumti të KEK-ut.**

Mbledhja e të hyrave të Kosovës 2014 nga sistemit i saj i gjenerimit të energjisë elektrike arriti në 214.000.000 €. Sipas vlerësimit të IEEFA-së sistemi do të gjenerojë rreth 400 milionë euro deri më 2021. Ndoshta deri në tri të katërtat e këtyre të ardhurave do të duhet të shkojnë për të mbështetur TCKR-në nëse ndërtohet. Duhet të ketë një ristrukturim i rëndësishëm i shpërndarjes së të ardhurave në kuadër të sistemit dhe për KEK-un.

Përveç humbjes së të ardhurave për KEK-un – dhe përveç kontrollit më të kufizuar që do të ushtrojë qeveria mbi të ardhurat nga sistemi i energjisë elektrike – TCKR-ja do të ketë ndikime të mëtejshme fiskale, edhe pse Ministri i Zhvillimit Ekonomik ka deklaruar se nuk do të ketë shpenzime nga buxheti i Kosovës për termocentralin e ri,<sup>93</sup> pohim që IEEFA e vë në dyshim.

<sup>92</sup> Banka Botërore ka identifikuar humbje të energjisë elektrike e me këtë të të hyrave si rezultat i aktivitetit të paligjshëm si dhe humbjeve teknike të cekura nga ZRRE-ja.

<sup>93</sup> <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,5394>

Qeveria e Kosovës ka një kredi të papaguar prej 225 milionë eurosh nga KEK-u. Në vitin 2014, është hequr dorë nga pagesat e interesit dhe kredia është duke u ristrukturuar.<sup>94</sup> Heqja dorë nga interesi është një formë e borxhit të anuluar, një formë e subvencionimit nga qeveria e Kosovës për sistemin e energjisë elektrike. Do të duhet të bëhet zgjidhja përfundimtare e kredisë pasi që KEK-u po përballlet me reduktim të ndjeshëm të të hyrave, dhe mënyra se si zgjidhet kredia do ketë implikime fiskale për qeverinë.

Fusha e dytë e ndikimit fiskal ka të bëjë me të ardhurat e familjeve të varfra në Kosovë, që i plotësojnë kriteret për tua paguar energjinë elektrike sipas rregulloreve për ndihmën sociale në Kosovë. Qeveria tashmë shpenzon 4.5 milionë në vit për këtë gjë. Përmes kësaj skeme të ndihmës sociale për familjet që i plotësojnë kushtet paguhen 400 kWh energji elektrike në muaj.<sup>95</sup> Një rritje e kostos së energjisë elektrike nga TCKR-ja do të vendoste presion mbi qeverinë ose për të rritur alokimet në buxhetin vjetor ose për të zvogëluar përfitimet nëpërmjet ndryshimeve të programit.

Një fushë e tretë e shqetësimit fiskal buron nga ajo se si qeveria e Kosovës ka bërë historikisht alokime të drejtpërdrejta në sistemin e energjisë elektrike për të kompensuar deficitet. Këto alokime vjetore janë zvogëluar me kalimin e kohës.<sup>96</sup> Zyrtarë të qeverisë ia atribuojnë reduktimet në shpenzime përmirësimeve në mbledhjen e të hyrave. Është e arsyeshme të parashikohet se me një rritje të shpejtë të çmimeve të energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës më shumë të ardhura do të përfundojnë pa u mbledhur. Rreziku këtu qëndron në atë se sërish do t'i duhet qeverisë së Kosovës të rris pagesat e subvencioneve nga të ardhurat e saj të fondit të përgjithshëm për sistemin e energjisë elektrike.

Rreziqet e tilla kërkojnë analizë të thellë. Një studim i ndikimit fiskal që analizon të hyrat aktuale, shpenzimet dhe borxhin nga sistemi energjetik, si do të ndryshojnë ato dhe çfarë rolesh dhe përgjegjësish të reja janë marrë, është vendimtare në minimizimin e rrezikut për buxhetin e qeverisë së Kosovës.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 6: Kostot e ndërtimit për termocentralin mund të jenë shumë më të larta se që parashikohen.**

Siç është cekur më herët në këtë raport, shumë projekte të termocentraleve me thëngjill kanë rritje të konsiderueshme të kostos dhe vonesa në orarin gjatë ndërtimit. Për shembull, siç tregohet në figurën 3, kostoja përfundimtare e termocentralit me thëngjill Šoštanj 6 në Slloveni, i përfunduar kohët e fundit, ishte më shumë se dyfishi i kostos që ishte parashikuar në vitin 2006. Ndërtimi i termocentralit në Kosovë do të kërkonte transportimin e shumicës së artikujve të

<sup>94</sup> <http://www.kek-energy.com/doc/publikime/Grant%20Thorton%20Financial%20Statement%20for%20year%20ended%2031%20December%202014.pdf>

<sup>95</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_i\\_Qeverise\\_eng\\_.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_eng_.pdf)

<sup>96</sup> <http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/06/4.-KEDS-PRIVATISATIÖN-IN-THE-ENERGY-SECTOR.pdf>

nevojshëm për ndërtim prej jashtë Kosovës,<sup>97</sup> duke vendosur ato shpenzime përtej kontrollit të qeverisë.

Faktori më i rëndësishëm i rrezikut lidhur me rritjen e shpenzimeve të ndërtimit rezulton nga zotimi publik për *Termocentralin Kosova e Re* i Bankës Botërore dhe qeverisë amerikane (diskutuar më poshtë). Ndërtuesit të cilët e konsiderojnë termocentralin si prioritet politik të këtyre dy mbështetësve të fuqishëm kanë një avantazh të natyrshëm negociues gjatë përcaktimit të çmimit fillestar të ndërtimit për projektin dhe në çdo kontest për çmimet gjatë procesit të ndërtimit. Është po ashtu e paqartë se me çfarë rregullash të prokurimit do të qeverisen ofertat dhe do të përzgjidhen ndërtuesit për termocentralin.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 7: Termocentralet me thëngjill që djegin linjit ka të ngjarë të prodhojë emetime të papranueshme.**

India dhe Kina, dy vende me histori të kohëve të fundit të rritjes ekonomike, tani po përpiqen të ulin varësinë e tyre nga teknologjia me djegie të thëngjillit, kryesisht për shkak të problemeve të ndotjes së ajrit. Procesi i largimit nga thëngjilli në këto vende është kompleks, por është bërë i menaxhueshëm për shkak të madhësisë, thellësisë financiare dhe diversitetit të ekonomive. Për dallim, Kosova është një ekonomi e vogël në rritje që ka pak hapësirë për gabime në një investim aq të madh sa TCKR-ja.

Planet e mëhershme të termocentraleve supozonin termocentralet nën-kritike të thëngjillit, një burim shumë ndotës i energjisë kur kombinohet me linjit. Komentet e fundit të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik duket se nënkuptojnë se propozimi i ri do të jetë për një termocentral super-kritik, d.m.th., një që është më pak ndotës. Termocentralet super-kritike janë zakonisht më të mëdha se 500 MW, nuk djegin linjitin dhe janë më të shtrenjtë se sa termocentralet nën-kritike.<sup>98</sup> Kërkohej punë shtesë inxhinierike, dizajnuese dhe financiare për të përcaktuar nëse kjo është një drejtim i realizueshëm.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 8: Përjashtimet politike që me sa duket janë dhënë nga Banka Botërore dhe Departamenti Amerikan i Shtetit do të çojnë në kosto më të larta.**

Presidenti i Bankës Botërore, Jim Yong Kim ka premtuar mbështetje për projektin (shih Seksioni VI më poshtë), pavarësisht nga fakti se banka është duke u larguar nga financimi i termocentraleve me thëngjill përveç në rrethana të rralla. Sekretari amerikan i Shtetit, John Kerry ka premtuar gjithashtu mbështetjen e SHBA-së. Mbështetja e Sekretarit Kerry për termocentralin duket të jetë e bazuar në dëshirën për të reduktuar emetimet e gazit serrë, por deklarata e tij nuk ka ndonjë bazë të besueshme. I vetmi termocentral i thëngjillit për të cilin ka disa përskrime

<sup>97</sup> Sierra Club, "Affordable Electricity for Kosovo? A Review of World Bank Group Cost Estimates. For New Lignite-fired Plants in Kosovo," 2011, <https://www.sierraclub.org/sites/www.sierraclub.org/files/uploads-wysiwig/Affordable%20Electricity%20for%20Kosovo.pdf>

<sup>98</sup> [https://www.iea.org/publications/freepublications/publication/Power\\_Generation\\_from\\_Coal2011.pdf](https://www.iea.org/publications/freepublications/publication/Power_Generation_from_Coal2011.pdf), shih fq. 13 për mostrat globale të madhësive të termocentraleve.

në Kosovë deri më tani është termocentrali nën-kritik me djegie linjiti. Kjo teknologji është e llojit të termocentralit më ndotës me thëngjill.

Këto dy miratime në fakt janë heqje dorë nga politika e Bankës Botërore për ndryshimet klimatike dhe politikat e saj të përgjithshme për të ndihmuar të varfrit. Ato gjithashtu duket se e përjashtojnë Kosovën nga të gjitha standardet serioze klimatike që i mban Departamenti Amerikan i Shtetit. Këto përjashtime politike sigurojnë një rrugë të menjëhershme përpara për projektin. Siç është vënë në dukje në këtë dokument, niveli i rrezikut financiar dhe i kapacitetit siguron që këto palë do të thirren sërisht për një mbështetje edhe më të madhe. Është shumë e mundshme që problemet e kapacitetit organizativ që e torturojnë qeverinë e Kosovës ka të ngjarë të kthehen në barrë të mëtejshme financiare për sponsorët e saj amerikanë. Në disa pika këto barra financiare shtesë mund të çojnë në një rishqyrtim të përjashtimeve politike.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 9: Marrëveshjet ndërkombëtare për politikën klimatike mund të vendosin kufizime mbi prodhimin e energjisë nga thëngjilli.**

Potenciali për iniciativat dhe marrëveshjet për politikat klimatike ndërkombëtare dhe ndikimi i tyre në Kosovë paraqesin një rrezik të veçantë. Natyra e vazhdueshme e dialogut, bashkë me marrëveshjen ndërkombëtare të arritur në Paris në dhjetor të vitit 2015 është duke krijuar iniciativa në mbarë botën të cilat kufizojnë përdorimin e lëndëve djegëse fosile, veçanërisht thëngjillit. Shumë prej partnerëve ekonomikë të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe më gjerë kanë miratuar politika dhe programe për të adresuar ndryshimet klimatike. Kosova aktualisht e bazon më shumë se 95 për qind të gjenerimit të energjisë së saj elektrike në thëngjill, dhe futja në funksion e *Termocentralit Kosova e Re* vetëm se do të përjetësojë varësinë nga thëngjilli. Mbështetja e vazhdueshme në prodhimin e energjisë nga thëngjill është rrezik.

## **FAKTORI I RREZIKUT NR. 10: Kundërshtimi publik për termocentralin në Kosovë paraqet një rrezik material.**

Ka pasur kundërshtime publike për katër ndikimet specifike të *Termocentralit Kosova e Re*. Së pari, zhvendosja e detyruar e banorëve të Kosovës dhe shkelja e mundshme e standardeve të Bankës Botërore për zhvillim mbetet një kundërthënie e vazhdueshme kryesore publike.<sup>99</sup> Së dyti, banorët kanë ngritur pyetje rreth përkeqësimit të cilësisë së ajrit në Kosovë, që do të shkaktohet nga djegia e linjtit me teknologji dalë mode. Së treti, mbështetja e Kosovës në gjenerimin nga djegia e thëngjillit për 95 për qind të prodhimit të saj vjetor të energjisë sjell kritika për nivelet e emetimeve të gazrave serrë që ajo krijon. Së katërti, kundërshtimi i kohëve të fundit i ritjes së

<sup>99</sup>Downing, T., "Does the Kosovo Power Project's Proposed Forced Displacement of Kosovars Comply with International Involuntary Resettlement Standards?," 2014, [http://www.kosid.org/file/repository/Does\\_the\\_Kosovo\\_Power\\_Project\\_s\\_Proposed\\_Forced\\_Displacement\\_of\\_Kosovars\\_Comply\\_with\\_International\\_Involuntary\\_Resettlement\\_Standards.pdf](http://www.kosid.org/file/repository/Does_the_Kosovo_Power_Project_s_Proposed_Forced_Displacement_of_Kosovars_Comply_with_International_Involuntary_Resettlement_Standards.pdf)

çmimeve të energjisë elektrike nën sistemin ekzistues tregon presionin e madh me të cilin do të përballlet çdo projekt i ri që rrit çmimet në mënyrë të ndjeshme.<sup>100</sup>

Çështjet e ngritura individualisht dhe në mënyrë kumulative paraqesin një rrezik material<sup>101</sup> për zbatimin e suksesshëm të TCKR-së. Kundërshtimi publik i termocentraleve të thëngjillit dhe projekteve të tjera me lëndë djegëse fosile në shumë vende në botë janë kombinuar me ekonominë e dobët financiare të projektit për të anuluar propozimet.<sup>102</sup>

## VI. Rëndësia e rolit të Bankës Botërore në zhvillimin e *Termocentralit Kosova e Re*

### A. Pozita e Bankës Botërore ndaj thëngjillit, klimës dhe varfërisë

Banka Botërore, me mbështetjen e Thesarit të SHBA-së, ka miratuar një politikë në vitin 2013 në të cilën banka deklaroi kundërshtimin e saj ndaj gjenerimit me djegie thëngjilli:

Grupi i Bankës Botërore do të pushojë së ofruari mbështetje financiare për projekte të reja të gjenerimit të energjisë nga thëngjilli, përveç në rrethana të rralla kur nuk ka alternativa të mundshme në dispozicion për të plotësuar nevojat bazike të energjisë dhe kur mungojnë burime të tjera të financimit. Financimi nga sektori privat do të jetë opsioni i preferuar, por aty ku angazhohet Grupi i Bankës Botërore, do të aplikohen kriteret ekzistuese të shqyrtimit për projektet e thëngjillit.<sup>103</sup>

Banka Botërore dhe qeveria amerikane kanë treguar se mbështetja për TCKR-në do të kualifikohet si mbështetje në "rrethana të rralla."<sup>104</sup> Në gusht 2013 Presidenti i Bankës Botërore Jim Yong Kim tha se mbështetja e tij për TCKR-në doli nga një angazhim për të parandaluar ngrirjen e të varfërve në apartamentet e tyre.<sup>105</sup>

Misioni parësor i Bankës Botërore është promovimi i zhvillimit që do të lehtësonte varfërinë. Sipas dokumentit të politikës së saj për ndryshimin e klimës 2013, "Grupi i Bankës Botërore është duke intensifikuar fokusin e saj në objektivin që t'i jap fund varfërisë dhe të nxis prosperitetin e përbashkët."

<sup>100</sup> Gazeta Express ", 70 OJQ-të, me peticionin e qytetarëve kundër rritjes së energjisë elektrike," Shtatori 2014, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/70-ojq-bashke-me-qytetaret-peticionkunder-shtrenjtimit-te-energji-se-elektrike-44296/?archive=1>

<sup>101</sup> IEEFA, Material Risks report, October 2014, [http://www.ieefa.org/wp-content/uploads/2014/10/IEEFA.OCI\\_Material-Risks.compressed.pdf](http://www.ieefa.org/wp-content/uploads/2014/10/IEEFA.OCI_Material-Risks.compressed.pdf)

<sup>102</sup> Sierra Club, "Move Beyond Coal, The Global Movement in 2014," <https://www.sierraclub.org/sites/www.sierraclub.org/files/Move-Beyond-Coal-2014.pdf>

<sup>103</sup> E&E Publishing, "Toward a Sustainable Energy Future for All: Directions for the World Bank Group's Energy Sector," [http://www.eenews.net/assets/2013/06/27/document\\_cw\\_01.pdf](http://www.eenews.net/assets/2013/06/27/document_cw_01.pdf)

<sup>104</sup> Bloomberg Business, "Coal-Fired Plant in Kosovo Tests World Bank Clean-Air Pledge," June 2014, <http://www.bloomberg.com/news/articles/2014-06-01/coal-versus-poverty-in-kosovo-tests-world-bank-clean-air-pledge>

<sup>105</sup> <http://www.bloomberg.com/news/articles/2013-04-17/kim-says-world-bank-can-t-reject-coal-if-people-freez>

Banka Botërore bën deklaratën lidhur me varfërinë energjetike më konkrete duke e lidhur koston e lartë të energjisë me jo-konkurrencën ekonomike duke vënë në dukje se shpenzimet e tilla gjithashtu dëmtojnë aftësinë e të varfërve që të kenë qasje në burimet themelore të energjisë: "Megjithatë shpenzimet e larta të energjisë do të rrezikojnë përballueshmërinë e nevojave bazike të energjisë për familjet dhe konkurrueshmërinë e industrisë... Kur mbahen subvencionet, ato duhet të jenë rreptësisht të drejtuara kah të varfrit."<sup>106</sup>

Banka Botërore gjithashtu çon më tej teorinë e përgjithshme se qasja në energji stimulon rritjen ekonomike, gjë që ndihmon të varfrit dhe sjell përmirësime të mëdha ekonomike, siç përshkruhet më poshtë:

"Energjia është një motor i rëndësishëm i rritjes ekonomike, nga e cila varen edhe ulja e varfërisë edhe prosperiteti i përbashkët. Rritja ekonomike përfshirëse është mjeti i vetëm më efektiv për uljen e varfërisë dhe rritjen e prosperitetit. Shumica e aktivitetit ekonomik do të ishte i pamundur pa energji. Energjia adekuate, e qëndrueshme dhe me çmime konkurruese moderne është thelbësore për zhvillimin e biznesit, krijimin e vendeve të punës, gjenerimin e të ardhurave dhe konkurrueshmërinë ndërkombëtare.

"Performanca efikase dhe financiarisht e shëndoshë e sektorit është një kusht paraprak për energji të përballueshme dhe të qëndrueshme. Aftësia për të nxjerr shpenzimet është thelbësore për shëndetin financiar dhe rivendosjen e qëndrueshmërisë ekonomike të furnizuesve të prekur. Një nxjerrje e tillë e shpenzimeve varet nga heqja graduale e kontroleve të çmimeve që shkaktojnë caktimin e çmimeve më të ulëta (underpricing); futjen e sistemeve efikase të pagesave nëpërmjet matjes më të mirë, faturimit, inkasimit dhe standardeve të shërbimit; dhe me kalimin e kohës reduktimin dhe eliminimin e vjedhjes nëpër zinxhirin e furnizimit, lidhjet e shkurtra, tjetërsimin e karburantit dhe etiketimin e gabuar. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimeve të energjisë dhe gazit natyror shpesh do të rezultojë në operim më efikas, duke përfshirë edhe reduktimin e humbjeve. Efikasiteti operacional, nga ana tjetër, do të rivendos aftësinë e shërbimeve për të financuar investime të reja dhe për të dhënë një kontribut pozitiv për ekonominë në të gjitha rrethanat, por veçanërisht në vendet me mungesë serioze të energjisë. Përmirësimi i financave të një shërbimi publik duke reduktuar humbjet komerciale dhe rritur furnizimet e mundshme të energjisë përmes uljes së humbjeve teknike janë plotësime efektive për investimin e ri."

Perspektiva e politikës së Bankës Botërore, thënë shkurt, përmbledhet me këtë: shumë probleme dhe joefikasitete në lidhje me politikën e zhvillimit të energjisë, zbatimin praktik dhe vullnetin politik lidhur me prodhimin e energjisë mund të dëmtojnë rritjen ekonomike dhe progresin për të varfrit.

<sup>106</sup> E & E Botime, "Drejt një të ardhmeje të qëndrueshme të energjisë për të gjithë: Udhëzime për Sektorin e Energjisë të Grupit të Bankës Botërore," [http://www.eenews.net/assets/2013/06/27/document\\_cw\\_01.pdf](http://www.eenews.net/assets/2013/06/27/document_cw_01.pdf)

## B. Banka Botërore dhe *Termocentrali Kosova e Re*

Dokumenti Opsionet Energjetike të Kosovës 2011 i përgatitur nga Banka Botërore vë çështjet e politikave në një fokus të veçantë të Kosovës. Dokumenti vë në dukje dilemën e një sistemi në të cilin konsumatorët shtëpiak paguajnë më pak për energjinë elektrike se kostoja e operacioneve të sistemit. Banka Botërore po ashtu identifikon se si humbjet dhe joefikasiteti në sistem minon më tej sistemin energjetik të Kosovës si një mundësi për investim të qëndrueshëm.

"Tarifat aktuale që u ngarkohen konsumatorëve nuk janë pasqyrim i kostove: sepse në pjesën më të madhe, konsumatorët familjarë janë të subvencionuar nga konsumatorët jo-familjarë. Tarifat familjare në tërësi vlerësohen të jenë afërsisht 20-30 për qind më të ulëta se kostot e përgjithshme financiare të furnizuesve, ndërsa disa tarifa industriale dukshëm tejkalojnë nivelin që pasqyron koston. Lëvizja drejt tarifave që pasqyrojnë më shumë kosto do të ndikojë në kërkesën sipas kategorive të ndryshme të konsumatorëve me ndikim (siç diskutohet në seksionin e ardhshëm), në varësi të elasticitetit të çmimit të kërkesës së konsumatorëve.

"Shumica e kërkesës së matur të energjisë elektrike në Kosovë është për banim (rreth 63 për qind në vitin 2010), e pasuar nga industria. Humbjet teknike dhe jo-teknike në shpërndarje së bashku përfaqësojnë më shumë se 40 për qind të totalit të energjisë elektrike të prodhuar. Humbjet jo-teknike janë zvogëluar në vitet e fundit nga rreth 30 për qind në vitin 2006 në 24 për qind në vitin 2010. Humbjet në vitin 2010 arritën në rreth 2,000 GWh. Sistemi aktual i ngrohjes qendrore në Prishtinë dhe Gjakovë, nëse nuk operohen si duhet, gjithashtu mund të ngarkojnë sistemin e energjisë me një kërkesë shtesë prej 70-100 MW gjatë dimrit.

"Reduktimet e humbjeve jo-teknike do të reduktojnë konsumin e energjisë elektrike për shkak se familjet që nuk kanë matës është dëshmuar se kanë shfrytëzuar dukshëm më shumë energji elektrike (në disa raste pothuajse dyfishin e familjeve me orë të rrymës). Adresimi i vjedhjes dhe mospagesës për konsumin e energjisë elektrike nga familjet të cilat kanë matës do të reduktojnë kërkesën dhe do të kishte efekt të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave të kompanisë energjetike (sepse një pjesë e madhe e 'humbjeve' jo-teknike janë në të vërtetë energji elektrike që është konsumuar, por që nuk është paguar).

I paevitueshëm në diskutimin nga Banka Botërore të çështjeve të gjëra ekonomike dhe financiare të energjisë në lidhje me tarifat është pikëpamja se çmimi i energjisë elektrike për kosovarët duhet të rritet në mënyrë që të bëhen investime në sektorin e energjisë. Veprimet e fundit nga Qeveria e Kosovës për të rritur çmimin e energjisë elektrike duket se synojnë të ndryshojnë këtë "çmim të ulët" (underpricing), duke rritur shumat që paguajnë familjet në krahasim me grupet e tjera të konsumit.

Është pikërisht në pjesën e koston së kapitalit dhe çmimit të energjisë elektrike për popullatën e Kosovës ku fleksibiliteti i financimit të Bankës Botërore – për TCKR-në apo ndonjë projekt tjetër zhvillimor të energjisë – mund të sjell ndryshim.

Politika dhe veprimet e Bankës Botërore në lidhje me Kosovën nuk kanë një bazë të shëndoshë të politikave. Së pari, nuk ka dëshmi për hipotermi të përhapur në Kosovë. Kosovarët marrin një



nivel të ulët të subvencionit për energjinë dhe jetojnë me çmime tashmë të rënda dhe sistemi ende siguron ngrohje. Së dyti, ekzistojnë dëshmi të bollshme nga qeveria dhe OJQ-të se kosovarët po kanë probleme për të paguar faturat e tyre. Çdo rritje e kostos së një nevoje elementare do të thotë se të varfrit duhet t'ia dalin pa disa gjëra të tjera elementare. *Termocentrali Kosova e Re* do të rrisë çmimet e energjisë elektrike duke vënë presion mbi familjet që t'ia dalin me më pak ushqim, të mos paguajnë qira ose të mos blejnë gjërat e tjera të nevojshme. Deklarata e Dr. Kim pa nevojë vendos një rëndom domosdoshmëri shtëpiake kundër tjetrës, një pozitë e palakmueshme për një agjenci që mbështet njerëzit e varfër.

## C. Varfëria në Kosovë, çmimi i energjisë elektrike dhe *Termocentrali Kosova e Re*

Çmimi i energjisë elektrike për shumicën e popullatës në Kosovë është i papërbalueshëm tani dhe ai është veçanërisht i paarritshëm për ata që jetojnë nën kufirin e varfërisë. *Termocentrali Kosova e Re* do të shtojë kosto të tjera të konsiderueshme në sistemin e Kosovës, që do të vë presion në rritje mbi çmimin e energjisë elektrike dhe pa dyshim do të rris çmimet. Është çështje politike se si ato presione të çmimeve integrohen në sistem dhe se si balancohen ekuitetet.

## D. Mjetet e Bankës Botërore për të adresuar problemin e varfërisë

Banka Botërore përdor një gamë të gjerë të mjeteve dhe iniciativave strategjike për të ndihmuar vendet në arritjen e objektivave të tyre të energjisë, klimës dhe uljen e varfërisë.<sup>107</sup> Këto nisma përfshijnë funksione të gjëra të planifikimit dhe integritit, financimin e të gjitha formave të energjisë së ripërtërishme, alternativat ndaj thëngjillit, efikasitetin e energjisë, reformat e tarifave dhe caktimit të çmimeve dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serrë. Kosova ka të drejtë të marrë kredi<sup>108</sup> dhe grante nga Programi i Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtar i Bankës Botërore (IDA).<sup>109</sup>

Në rastin e TCKR-së, Banka Botërore ka mjete të shumta financiare që do mund ta bënin termocentralin me thëngjill të përbalueshëm për Kosovën. Banka mund të sigurojë financim që rregullon çdo aspekt të kredisë prej 945 milionë eurosh që kërkohet për pjesën e borxhit të projektit. Ajo mund të ofrojë kushte bujare për shlyerjen e principalit (shtyrjen e pagesës së principalit), të siguroj norma të ulëta interesi dhe periudha afatgjata për t'ia paguar. Ajo mund të negociojë shumë dispozita që lidhen me pagesat dhe dështimin në pagesa në favor të vendit huamarrës. Banka Botërore ka një zë bukur përcaktuar për termat dhe kushtet e pjesëmarrjes së

<sup>107</sup> E & E Botime, "Drejt një të ardhmeje të qëndrueshme të energjisë për të gjithë: Udhëzime për Sektorin e Energjisë të Grupit të Bankës Botërore," [http://www.eenews.net/assets/2013/06/27/document\\_cw\\_01.pdf](http://www.eenews.net/assets/2013/06/27/document_cw_01.pdf). Agjencia ofron një gamë të gjerë të mundësive operacionale në faqet 14-28.

<sup>108</sup> Nuk është e qartë në këtë pikë se çfarë do të bëjë Banka Botërore me projektin *Termocentrali Kosova e Re* lidhur me financimin e projektit. Fondi kryesor i Bankës Botërore, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) ofron kushte shumë fleksibile financimi, por ato janë kredi standarde. Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar e Bankës Botërore (IDA) ka fleksibilitet shumë më të madh për të siguruar afate më të gjata dhe norma shumë më të ulëta të interesit. IDA, megjithatë është shumë më e vogël. Për shembull, ajo shpenzoi \$ 18 miliardë gjatë tri viteve të fundit, gjysma e tyre në Afrikë. Një projekt i madh sa ky i Kosovës mund të marr shumicën e ndarjes jo-afrikane brenda një viti. Për qëllime të këtij dokumenti, për shkak të interesit të sektorit privat modelimi përgjithësisht merr një kredi me principal dhe interes.

<sup>109</sup> Banka Botërore, Kosovë, <http://www.worldbank.org/en/country/kosovo>

investitorëve përmes ekuitetit në projektin e propozuar. Nëpërmjet termave dhe kushteve të veta, ajo mund të risë rentabilitetin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe të ofrojë stimuj shtesë për pjesëmarrje.

Nga pikëpamja e familjeve të Kosovës, mjetet financiare të Bankës Botërore, për shembull, do të mund të ofrojnë norma mjaft të ulëta të interesit për të ruajtur ose ulur tarifat e energjisë elektrike me futjen e TCKR-së. Megjithatë, një subvencion i tillë do të jetë i madh dhe do të kërkojë një zotim afatgjatë për të menaxhuar rreziqet e tjera të identifikuar në këtë dokument. Banka Botërore, sipas modeleve tona, do të duhet të japë një subvencion për normën e interesit duke filluar me 2.8 miliardë euro për më shumë se 30 vjet thjesht për të mbajtur këto çmime të energjisë elektrike edhe me inflacion. Megjithatë, një subvencion i tillë nuk do të bëjë asgjë për të korigjuar koston e tanishme jo-proporcionalisht të lartë të sistemit të energjisë elektrike me thëngjill në Kosovë.

Sjellja e çmimit të energjisë elektrike në përpurthje me nivelin e të ardhurave të atyre që jetojnë nën nivelin e varfërisë në Kosovë do të kërkojë subvencione më të mëdha dhe të vazhdueshme për të bërë termocentralin me thëngjill ekonomikisht të qëndrueshëm si një instrument për uljen e varfërisë.

## VII. Potencial për energji të ripërtërishme dhe efikasitet të energjisë në Kosovë

IEEFA përfundon se thëngjilli nuk është opsioni me kosto më të ulët për Kosovën, dhe rekomandon që në vend të kësaj Banka Botërore të marrë parasysh financimin e zhvillimit të energjisë së ripërtërishme dhe efikasitetit të energjisë në Kosovë.

Ky përfundim është arritur në bazë të tri propozimeve:

- Se financimi i Bankës Botërore është i gjerë dhe i aftë të financojë çdo lloj të zhvillimit të energjisë. Kushtet e financimit të Bankës Botërore janë mjaft fleksibile për të bërë shpenzimet kapitale të çdo zgjedhje të teknologjisë të përballueshme.
- Se dokumenti i Bankës Botërore për opsionet e energjisë në Kosovë 2011 e dokumenton se shpenzimet operationale për energji të erës dhe solare janë më të ulëta se ato të gjenerimit me thëngjill.
- Se kostot operative afatgjata të gjenerimit të energjisë nga era dhe dielli nuk janë inflacioniste për shkak se kostoja e energjisë nga era dhe dielli janë zero; kostot operative të termocentralit të thëngjillit, nga ana tjetër, rriten çdo vit me inflacionin.

Dan Kammen, profesor i shquar i energjisë në Universitetin e Kalifornisë në Berkley dhe ish specialist kryesor teknik për energjinë e ripërtërishme dhe efikasitetin e energjisë në Bankën Botërore, gjeti në një raport të vitit 2013 se sistemi në Kosovë teknikisht mund të përfshijë

dukshëm më shumë energji të erës, diellit dhe efikasitet të energjisë.<sup>110</sup> Një investim i tillë do të rezultonte në vende pune, zhvillim të ri ekonomik, dhe sistem më efikas të energjisë elektrike.

Dokumenti i Bankës Botërore për opsionet e energjisë 2011 bën një krahasim në matjet e kostos për opsionet e ndryshme të energjisë, duke treguar se shpenzimet e operimit të prodhimit të energjisë së erës dhe asaj diellore janë më të ulëta se shpenzimet e operimit të termocentralit me linjit.

**Figura 11: Dokumenti i Bankës Botërore për opsionet e energjisë: Kostot operacionale të impianteve të erës, diellit dhe linjtit <sup>111</sup>**

Lloji i Burimit të Energjisë	Kosto EUR / MWh
Era	10.68
Foto voltaike	19.68
Termocentrali me linjit	20.22

Me kalimin e kohës, çmimi i energjisë së erës dhe asaj diellore nuk rritet. Kjo nuk është e vërtetë për gjenerimin nga djegia e thëngjillit.<sup>112</sup> Çmimet e energjisë së erës dhe asaj diellore kanë një ndikim anti-inflacion mbi çmimet e energjisë. Kjo ka një ndikim zbutës në rritjet e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët.

Raporti Kammen argumenton se përfshirja e më shumë energjie diellore dhe të erës në skenarët e planifikimit në Kosovë është teknikisht e realizueshme. Kostot operacionale favorizojnë erën dhe diellin para thëngjillit, dhe Banka Botërore mund të mbështesë financimin e energjisë së ripërtërishtme në një mënyrë që promovon qëllimet e përbalueshmërisë së energjisë.

## Përfundim

Futja e *Termocentralit Kosova e Re* në sistemin e energjisë elektrike në Kosovë do të shkaktonte rritjen e tarifave dhe do të vendoste një barrë të madhe të borxhit mbi shtetin e ri.

Projekti i *Termocentralit Kosova e Re* ka rreziqe të qenësishme, serioze që mund të çojnë në mospërbushjen e tij dhe në vështirësi të mëtejshme ekonomike. Edhe pse Kosova ka bërë progres kohëve të fundit në drejtim të zvogëlimit të varfërisë dhe papunësisë, rritja e saj ekonomike ka të ngjarë të mbetet në variantin më të mirë e parregullt dhe nuk ka gjasa të jetë në nivelet e nevojshme për të mbështetur termocentralin e propozuar.

<sup>110</sup>Renewable & Appropriate Energy Laboratory Energy & Resources Group, University of California, Berkeley, "Sustainable Energy Options for Kosovo," May 2012, <http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>

<sup>111</sup> Banka Botërore, Dokumenti për opsionet, f. 27 dhe 30.

<sup>112</sup> IEEFA "Shënim informues, Çmimet e energjisë në Indi," Maj 2014, [http://www.ieefa.org/wp-content/uploads/2014/05/IEEFA-Briefing-Note\\_IndianElectricityCoalPricing\\_4-May-2014.pdf](http://www.ieefa.org/wp-content/uploads/2014/05/IEEFA-Briefing-Note_IndianElectricityCoalPricing_4-May-2014.pdf). Shih faqen 7 për diskutim të dallimit ndërmjet tarifave të energjisë së erës dhe asaj diellore dhe thëngjillit në Indi.

Kosova mund të harmonizojë objektivat e veta për arritjen e rritjes ekonomike, zbutjen e varfërisë, dhe mbrojtjen e mjedisit duke investuar në energji të ripërtërishme dhe eficiencë të energjisë. Subvencionet e Bankës Botërore mund të përdoren më mirë për të mbështetur ato opsione. Nga perspektiva teknike, mjedisore, klimatike dhe financiare, Kosova do të përfitojë nga një zhvillim më i madh i energjisë së ripërtërishme.

# Instituti për Analiza Ekonomike dhe Financiare të Energjisë

Instituti për Analiza Ekonomike dhe Financiare të Energjisë (IEEFA) bën kërkime dhe analiza për çështjet financiare dhe ekonomike që lidhen me energjinë dhe mjedisin. Misioni i Institutit është që të përshpejtojë tranzicionin në një ekonomi diverse, të qëndrueshme dhe fitimprurëse të energjisë dhe të zvogëlojë varësinë nga thëngjilli dhe burimet e tjera jo-të ripërtërishme të energjisë. Më shumë informata mund të gjenden në [www.ieefa.org](http://www.ieefa.org)

## Për Autorët

**Tom Sanzillo, drejtor i financave për IEEFA**, është autor i disa studimeve mbi termocentralet me thëngjill, ndikimet e tarifave, analizat e kredive dhe strukturat financiare publike dhe private për industrinë e thëngjillit. Ai ka dëshmuar si dëshmitar ekspert, ka ligjëruar në trajnimet për financimin e industrisë energjetike, dhe citohet shpesh nga media. Sanzillo ka 17 vjet përvojë pune në Bashkinë dhe shtetin e Nju Jorkut në pozicione të ndryshme të larta financiare dhe menaxhimit të politikave. Ai është ish zëvendës i parë i Kontrollorit [Financiar] për shtetin e Nju Jorkut, ku mbikëqyri financat e 1,300 njësisve të qeverive vendore, menaxhimin vjetor të 44,000 kontratave të qeverisë, qindra auditimeve të performancës vjetore të programeve të qeverisë ku ai kishte në mbikëqyrje mbi 200 \$ miliardë në programet e kontratave shtetërore dhe lokale komunale dhe një fond pensional prej 156 miliardë \$ të investuar në nivel global.

Gjatë periudhës së hershme të karrierës së tij Tomi shërbeu në disa pozita që merreshin me varfërinë në Shtetet e Bashkuara. Ai organizoi qiramarrësit me të ardhura të ulëta, ka shërbyer si Drejtor Ekzekutiv i një organizate kundër varfërisë dhe ka zhvilluar strehim për njerëzit me të ardhura të ulëta në të gjithë shtetin e Nju Jorkut. Tomi ka shërbyer në një numër bordesh dhe komisionesh jofitimprurëse dedikuar reformës së mbështetjes me të ardhura për të varfrit.

Sanzillo kohët e fundit ka kontribuar me një kapitull të Doracaku i Oksfordit për Qeverinë dhe Politikën e Shtetit të Nju Jorkut për Zyrën e Kontrollorit të Shtetit të Nju Jorkut.

**David Schlissel, drejtor për analiza dhe planifikim të resurseve për IEEFA**, ka qenë një avokat rregullator dhe konsulent për çështje të tarifave të shërbimeve publike elektrike dhe planifikim të resurseve nga viti 1974. Ai ka dëshmuar si dëshmitar ekspert para komisioneve rregullative në më shumë se 35 shtete dhe para Komisionit Rregullator Federal të Energjisë dhe Komisionit Rregullator Bërthamor të SHBA-së. Ai gjithashtu ka dëshmuar si dëshmitar ekspert në procedurat në gjykatat shtetërore dhe federale në lidhje me shërbimet elektrike. Klientët e tij kanë qenë komisionet rregullatore shtetërore në Arkanzas, Kanzas, Arizona, New Mexico dhe Kaliforni. Ai po ashtu është konsultuar edhe për ndërmarrjet publike, qeveritë shtetërore dhe prokurorët e përgjithshëm, avokatët shtetërorë, qeveritë e qyteteve, dhe organizatat mjedisore kombëtare dhe lokale.

Schlissel ka diploma universitare dhe pas-universitare të inxhinierisë nga Instituti i Teknologjisë i Maseçusetsit dhe Universiteti i Stanfordit. Ai ka një diplomë *Juris Doctor* nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Stanfordit.

# SHTOJCA I: Shënim për Sistemet e të Dhënave

Janë bërë disa studime për Termocentralin e propozuar Kosova e Re, financiar kryesisht nga donatorët jashtë Kosovës. Ato ofrojnë disa të dhëna të dobishme. Dokumenti i Bankës Botërore për Opsionet 2011, "Dokumenti i Sfondit: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve të furnizimit me energji për Kosovën", paraqet disa planifikime dhe vlerësime të dobishme të kostove të energjisë në Kosovë. Kjo sigurisht është e datuar tani. Një vlerësim i fillimit të 2006<sup>1</sup> Dokumenti i Vlerësimit të Projektit LPTAP përmban një model financiar të dobishëm që është transparent. Raportet pas këtij, përfshirë edhe studimin e Bankës Botërore të vitit 2011 braktisin përdorimin e modelit transparent financiar për termocentralin. Raportet Vjetore të sistemit elektroenergjetik të Kosovës përmbajnë disa informata të dobishme. Megjithatë në tërë raportin ka shembuj të mospërputhjes së raportimit nga viti në vit, dhe kufizime mbi përdorimin e këtyre të dhënave të sistemit për qëllime analitike.

Megjithatë, modeli dhe konkluzionet e këtij dokumenti do të ishin ndihmues pamasë po të kishte pasur të dhëna sasiore në dispozicion në disa fusha. Studimet e ardhshme për TCKR-në dhe përpjekjet e ardhshme për reformat e ndërmarrjeve publike në Kosovë do të përfitojnë nga raportimi më relevant, i besueshëm dhe konsekuent i të dhënave në fushat e mëposhtme:

- Vlerësimet e kostove të ndërtimit të termocentralit rrjedhin nga projektet e detajuara, në kohë, aktuale, në nivel rajonal;
- Parashikimet e përditësuara, të detajuara, në kohë dhe aktuale të kostove të ndërtimit dhe operimit të energjisë të ripërtërishme në nivelin rajonal;
- Vlerësimet e përditësuara, të detajuara, në kohë, aktuale, në bazë rajonale dhe specifike për Kosovën të shpenzimeve operative për termocentralet e linjitet, impiantet diellore, të erës, dhe efikasitetin e energjisë.
- Një seri modelesh të besueshme dhe të integruara të planifikimit të burimeve që testojnë një seri të gjerë të supozimeve të energjisë;
- Modele të bëra publike dhe gjithëpërfshirëse të financimit të kompanive publike, që detajojnë në mënyrë të qëndrueshme të hyrat sipas klasifikimit të konsumit, identifikojnë kostot aktuale të sistemit të Kosovës dhe një raport transparent ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mënyrë të ngjashme, një plan financiar shumëvjeçar që parashikon të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë pesëvjeçare, i përshtatur për investime kapitale dhe ndryshime të tjera të rëndësishme.
- Një përputhje formale dhe konsekuente midis parashikimeve të kërkesës dhe konsumit aktual në baza vjetore;
- Përmirësimi i statistikave sociale që i lejon sistemit të ndërmarrjes publike dhe qeverisë së Kosovës për të kuptuar më mirë ndryshimin e dinamikës së të ardhurave familjare në nivelin nën-të ardhurave.

# Shtojca II: Llogaritja e kostos së integrimit të Termocentralit Kosova e Re në tregun e energjisë elektrike

Kjo shtojcë jep detaje shtesë që shpjegojnë se si modeli i IEEFA-s merr nga **kostoja e termocentralit** dhe pastaj e përkthen në një **çmim të energjisë elektrike** për familjet kosovare. Edhe pse termocentrali kushton 400% më shumë se kostoja aktuale e energjisë elektrike, rritja e çmimit për ekonomitë familjare do të jetë mesatarisht 33.8%, por mund të rritet deri në mbi 50% në vitin e parë të funksionimit.

Modeli i IEEFA-së supozon se sistemi gjenerues i Kosovës pa termocentralin e ri do të kërkonte një çmim mesatar të energjisë elektrike prej 84 euro/ MWh në vitin 2021 (shih Figura A2: 2021 Çmimi i sistemit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me Termocentralin Kosova e Re, në faqen 42). Me termocentralin e ri kostoja e energjisë elektrike në sistemin e Kosovës në tërësi do të jetë 107 euro/ MWh.

Ky termocentral, e cila do të sigurojë gati 50 për qind të energjisë elektrike për vendin do të vendos një presion në çmime që ato të rriten.

## Metodologjia

Për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për termocentralin dhe ndikimet e tij sociale kërkohet një metodë me pesë hapa:

- 1) Përcaktimin e çmimit bazë të energjisë elektrike 2015 për sistemin e Kosovës në tërësi dhe për familjet kosovare në veçanti.
- 2) Vlerësimin e çmimit të sistemit të energjisë elektrike për 2021, duke e përshtatur për inflacionin dhe integrimin e çmimit të TCKR-së, duke përcaktuar një çmim të ri të sistemit të energjisë elektrike për 2021 me termocentralin e ri.
- 3) Vlerësimin e çmimit të energjisë elektrike për familjet për 2021 pa TCKR-në duke e përshtatur për inflacion.
- 4) Duke përdorur sistemin aktual të ekuiteteve brenda sistemit rregullator të Kosovës në mes të sektorit të amvisërisë dhe pjesës tjetër të sistemit, të vlerësohet çmimi i ri i energjisë elektrike për familjet në vitin 2021 me futjen në përdorim të *Termocentralit Kosova e Re*.
- 5) Llogaritja e euro centëve aktual / kWh dhe dallimet në përqindje të çmimit të energjisë elektrike pa dhe me TCKR-në.

**Më poshtë janë dhënë përshkrimet e llogaritjeve specifike për çdo hap:**

**1) Përcaktimi i çmimit bazë të energjisë elektrike për 2015 për sistemin e Kosovës në tërësi dhe për familjet kosovare në veçanti.**

Çmimi referues i sistemit për vitin 2015 është nxjerr nga të dhënat aktuale të vitit 2014 të ofruara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Raportin Vjetor 2014. ZRRE shpalos sasinë e energjisë elektrike të konsumuar nga sistemi si tërësi, nga familjet kosovare si përqindje e të konsumit të përgjithshëm dhe paraqet çmimin e energjisë elektrike për familje.<sup>113</sup> Çmimi i përgjithshëm i sistemit të energjisë elektrike është llogaritur duke pjesëtuar shumën e parave të marra (EUR) me sasinë e energjisë elektrike të shpenzuar (MWh) bazuar në të dhënat e vërteta të vitit 2014 të ofruara nga ZRRE (Figura A1: 2014 Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorin familjar dhe jo-familjar). Çmimi i tërë sistemit i paguar për energjinë elektrike është 71 euro / MWh (ose 7.1 euro cent / kWh).

**Figura A1: 2014 Çmimi i energjisë për konsumatorin familjar dhe jo-familjar**

	2014 Çmimi për E/ MWh	PCT. Pjesa e Sistemit	Pjesa e 2014 MWh	2014 të hyrat aktuale
Çmimi për konsumatorë familjar: vlerat aktuale 2014	52,40 <sup>114</sup>	0,526 <sup>115</sup>	1,593,228.23	€ 83,485,159.04
Konsumatori jo-familjar	91,19	0,474	1,435,722.77	€ 130,912,840.96
Gjithsej - Të gjitha grupet e konsumatorëve	70,78		3,028,951.00 <sup>116</sup>	€ 214,398,000.00

**2) Vlerësimi i çmimit të sistemit të energjisë elektrike për 2021, duke e përshtatur për inflacionin dhe integrimin e çmimit të TC Kosova e Re, duke përcaktuar një çmim të ri të sistemit të energjisë elektrike për 2021 me termocentralin e ri.**

IEEFA supozon se qeveria e Kosovës do të zgjedh që çmimi i energjisë elektrike që u ngarkohet konsumatorëve në 2021 të mbuloj kostot e reja të TCKR-së dhe të paktën të jetë i krahasueshëm me kostot e vitit 2015 duke e përshtatur me inflacionin. Pjesa tjetër e kostos së

<sup>113</sup> Normat e tarifave të Kosovës janë shpjeguar në faqen 63 të Raportit Vjetor të ZRRE-së. Ka një varg normash të krijuara sipas klasifikimit të përdoruesve, shfrytëzimit dhe kohës. Shfrytëzimi aktual dhe të hyrat aktuale të mbledhura të dhëna nga ZRRE-ja në Raportin Vjetor janë përdorur për të nxjerrë një çmim mesatar të energjisë elektrike për sistemin në tërësi dhe për familjet. Çmimi i energjisë elektrike është dallohet në këtë raport nga struktura e normës tarifore. **Vlerësimet në këtë dokument rrjedhin nga shfrytëzimi aktual dhe dollarët aktual të paguar nga kosovarët, e jo nga oraret e normës tarifore.**

<sup>114</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Raporti Vjetor 2014 Tabela 6.18, f. 52, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>115</sup> ZRRE, Raporti Vjetor 2014 f. 48, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)

<sup>116</sup> ZRRE, Raporti Vjetor 2014 Tabela 6.17. faqe 51, paraqet konsumin e përgjithshëm të MWh të tërë sistemit dhe të hyrat e mbledhura kundrejt këtij konsumi, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf)



sistemit për 2021 është llogaritur duke marrë koston bazë prej 71 euro/ MWh në vitin 2015 dhe duke e përshtatur atë për inflacionin deri më 2021. Pjesa tjetër e koston së sistemit për vitin 2021 është 84 euro/ MWh.

Sipas përshtatjes së Bankës Botërore dhe IEEFA-së të bazuar në njoftimin e fundit, sistemi i Kosovës do të merre gjysmën e rrymës së saj nga TCKR-ja<sup>117</sup> në vitin 2021. Kur TCKR të jetë integruar me pjesën tjetër të sistemit elektroenergjetik të Kosovës, kostoja e re e përgjithshme e sistemit do të jetë 107.00 euro MWh.

**Figura A2: 2021 Çmimi për tërë sistemin i Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me Termocentralin Kosova e Re**

Komponentët e gjenerimit	Përqindja e sistemit	Çmimi (EUR/MWh)	Çmimi i ponderuar (EUR/MWh)
Pjesa tjetër e sistemit	50.6%	84.00	43,68
Termocentrali Kosova e Re	49.4%	128,17	63,32
Çmimi i kërkuar 2021			107.00

### 3) Vlerësimi i çmimit të energjisë elektrike për familjet për vitin 2021 pa TCKR duke e përshtatur për inflacion.

Edhe pse kosovarët kanë përjetuar rritje të ndjeshme në çmimin e energjisë elektrike në të kaluarën e afërt, ka të ngjarë të ndodhin edhe rritje të tjera në mes të viteve 2015 dhe 2021, para se TCKR-ja të futet ndonjëherë në përdorim. Duke supozuar një rritje prej 2 për qind në vit për konsumatorët familjar, normat e energjisë elektrike në Kosovë do të rriten nga 5.24 euro centë/ kWh në vitin 2014 në 5.9 euro centë/ kWh në vitin 2021. Këto rritje janë të shtyrë nga shpenzimet e tradicionale dhe të zakonshme të operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të energjisë elektrike dhe kufizimet politike të vendosura në rritjet vjetore.

### 4) Duke e përdorur sistemin aktual të ekuiteteve në kuadër të sistemit rregullator të Kosovës ndërmjet sektorit të amvisërisë dhe pjesës tjetër të sistemit, të bëhet vlerësimi i çmimit të ri të energjisë elektrike për familjet në 2021 me futjen në përdorim të Termocentralit Kosova e Re.

**Çmimi i energjisë elektrike** për familjet kosovare në vitin e parë të operimit të termocentralit Kosova e Re do të rritet nga 5.9 euro centë/ kWh në 7.9 euro centë / kWh, një rritje prej 33.8 për qind.

<sup>117</sup> Banka Botërore, "Dokumenti i përgjithshëm: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve të furnizimit me energji për Kosovën," Shtojca E: Gjenerimi nga termocentralet, f. 75, [http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo\\_generation\\_options\\_report\\_12312011.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo_generation_options_report_12312011.pdf)

Figura A3 më poshtë e përshtat çmimin e energjisë elektrike për familjet për ta harmonizuar me bilancin aktual të ekuiteteve në sistemin e Kosovës ndërmjet klasifikimeve të ndryshme të konsumatorëve.<sup>118</sup> Pas balancimit të ekuiteteve kundrejt kostos së sistemit për vitin 2021, amvisërive do tu duhet që të paguajnë 7.9 euro centë/ kWh për të akomoduar trysninë në çmim nga TCKR-ja në tërë sistemin. Kjo përbën një rritje prej 33.8 për qind të çmimit të energjisë elektrike në vitin e parë të funksionimit të TCKR-së.

**Figura A3: Ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë me dhe pa Termocentralin Kosova e Re (TCKR) në vitin e parë të funksionimit**

	Çmimi për amvisëritë EUR / MWh	Çmimi i sistemit EUR/ MWh	Raporti amvisëri - sistem
Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë 2014	52,40	71.00	0,738
Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për 2021 pa TCKR	59.00	84.00	0,702
Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për 2021 me TCKR	78,96	107.00	0,738
Diferenca me dhe pa TCKR	19,96		
Përqindja e diferencës me dhe pa TCKR	<b>33.8%</b>		

## 5) Llogaritja e euro centëve aktualë për kwh dhe dallimet e përqindjes nga çmimi i energjisë elektrike pa dhe me TCKR-në.

Sipas çdo skenari të modelit të të hyrave dhe konsumit familjar, çmimi i energjisë elektrike pas futjes në përdorim të TCKR-së paraqitet se do të marr një pjesë më të madhe të të ardhurave familjare. Familja mesatare evropiane paguan më pak se 6 për qind të të ardhurave të saj për energji elektrike. Aktualisht, familja mesatare kosovare me konsum mesatar mujor paguan 9.6 për qind të të ardhurave të saj për energji elektrike. Familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme paguajnë 13.4 për qind të të ardhurave të tyre për energji elektrike. Sistemi ekzistues i vitit 2015 është veçanërisht i papërbalueshëm për të varfrit. Edhe për konsum më të ulët se konsumi mesatar i energjisë elektrike (300 MW në muaj), një familje mesatare që jeton nën kufirin e varfërisë paguan 29.7 për qind të të ardhurave të saj për energji elektrike (Figura A4: Përqindja e të ardhurave të paguara nga familjet kosovare në vitin 2015 para dhe pas Termocentralin Kosova e Re në 2021).

Kur TCKR të hyj në funksion me 2021 çmimi i energjisë elektrike rritet si përqindje e të ardhurave familjare. Familjet mesatare do të paguajnë 12.9 për qind të të ardhurave për

<sup>118</sup> "Tarifat shtëpiake në përgjithësi vlerësohen të jenë afërsisht 20-30 për qind nën kostot e përgjithshme financiare të furnizuesve, ndërsa disa tarifa industriale dukshëm tejkalojnë nivelin reflektues të kostos." Banka Botërore, Dokumenti i përgjithshëm: Zhvillimi dhe vlerësimi i opsioneve të furnizimit me energji për Kosovën, fq. 4, [http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo\\_generation\\_options\\_report\\_12312011.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTENERGY2/Resources/Kosovo_generation_options_report_12312011.pdf)

energji elektrike dhe familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme do të paguajnë 18.0 për qind. Për familjet e varfra që konsumojnë më pak se familja mesatare, kostoja e energjisë elektrike rritet në 39.7 për qind të të ardhurave.

Sistemi aktual tashmë u kushton familjeve kosovare një pjesë disproporcionale të të ardhurave për energji elektrike. Futja në funksion e TCKR-së në kushtet e tregut vetëm do të rrisë barrën mbi buxhetin e ekonomive familjare.

**Figura A4: Përqindja e të ardhurave të paguara nga familjet kosovare në vitin 2015 para dhe pas Termocentralin Kosova e Re në 2021**

	Të ardhurat për kokë banori	Çmimi vjetor i energjisë elektrike	% e të ardhurave për energjinë elektrike
<b>Të ardhurat 2015, 300 MWh</b>			
Mesatare për kokë banori	3597	212	5.2%
Të ardhura të ulëta dhe të mesme	2575	212	7.3%
Në varfëri	635	212	29.7%
<b>Të ardhurat 2015, 550 MWh</b>			
Mesatare për kokë banori	3597	389	9.6%
Të ardhura të ulëta dhe të mesme	2575	389	13.4%
Në varfëri	635	389	54.5%
<b>2021- RITJA E ÇMIMIT PAS TCKR-SË</b>			
<b>Të ardhurat 2021, 300 MWh</b>			
Mesatare për kokë banori	4050	284	7.0%
Të ardhura të ulëta dhe të mesme	2899	284	9.8%
Në varfëri	714	284	39.7%
<b>Të ardhurat 2021, 550 MWh</b>			
Mesatare për kokë banori	4050	521	12.9%
Të ardhura të ulëta dhe të mesme	2899	521	18.0%
Në varfëri	714	521	72.8%


#### 6) Çmimi i ri i Termocentralit Kosova e Re kur të përfshihet kostoja e karbonit.

Çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë në vitin 2021 për TCKR-në pa koston e karbonit është 7.9 euro centë/ kWh. Nëse Kosova i nënshtrohet protokolleve standarde të karbonit të Bashkimit Evropian, atëherë çmimi i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë do të rritet në 8.83 euro centë për kilovat. Kjo do të përbënte një rritje prej 49.7% në çmimin e

energjisë elektrike për konsumatorët në vitin e parë të funksionimit të Termocentralin Kosova e Re.

Një tjetër mënyrë për të vlerësuar ndikimin në buxhetin e ekonomive familjare është të shikohet rritja e çmimit në vitin 2021 kundrejt një standardi të rëndomtë dhe të zakonshëm të rritjes së kostos. Është tipike për sistemet e ndërmarrjeve energjetike publike që të rrisin çmimin e energjisë elektrike në një mënyrë të ngadaltë dhe të qëndrueshme.<sup>119</sup> Kjo me sa duket u jep mundësi familjeve dhe bizneseve që të përshtatin buxhetet e tyre me rrethanat dhe të bëjnë rritjen e ngadaltë dhe të qëndrueshme të modeleve tipike të të ardhurave. Për qëllimet e kësaj analize rritja e rëndomtë dhe e zakonshme është 2 për qind në vit prej vitit 2015 deri me 2020.<sup>120</sup> Me 2021, viti i parë i futjes në funksion të TCKR-së, çmimi për familjet e Kosovës do të rritet për 33.8 për qind. Kjo është më shumë se gjashtëmbëdhjetë herë e rritjes së rëndomtë dhe e zakonshme.

**Figura A5: Përqindja tipike e rritjes vjetore të çmimit të energjisë elektrike nga 2015 deri me 2020, krahasuar me rritjen e çmimit gjatë vitit të parë të operimit të Termocentralit Kosova e Re (2021)**



Sistemi aktual i energjisë elektrike veç është i papërbalueshëm. Çmimi i energjisë elektrike për të varfrit tashmë vendos tension tepër të madh në çdo buxhet familjar dhe është shumë përtej asaj të familjeve të tjera kosovare apo mesatares evropiane.

<sup>119</sup> Në raportin e vet Vjetor 2014 Komisionit për Energji Elektrike ofron çmimet për katër klasifikime të shfrytëzuesve të energjisë elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Raporti vjetor 2014 f. 51, [http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti\\_Vjetor\\_2014\\_eng.pdf](http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_eng.pdf). Ky është një zbulim i dobishëm. Raportet e vitit të mëhershëm megjithatë nuk ofrojnë informacion të tillë. Kjo parandalon vit-për-vit krahasime të çmimeve. Ky gabim raportimit është veçanërisht kritike çmimet e energjisë elektrike janë një shkak për shqetësim publik.

<sup>120</sup> Çmimi i energjisë për konsumatorë familjar në të gjithë Evropën është rritur rreth 3 për qind në vit nga 2008-2012, kryesisht si rezultat i taksave dhe kostove të rritit, pjesa energjetike e ngarkesës për energji elektrike ka rënë siç ka rënë edhe çmimi i energjisë me shumicë. Presioni në rritje të çmimit të energjisë evropiane në masë të madhe është parë për shkak të mbështetjes së vazhdueshme në lëndët djegëse fosile. Shih: Komunikatën nga Komisioni i Bashkimit Evropian, çmimet e energjisë dhe kostot në Evropë, [https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/20140122\\_communication\\_energy\\_prices\\_1.pdf](https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/20140122_communication_energy_prices_1.pdf). Ky dokument paraqet një rritje vjetore prej 2 për qind për familjet gjatë periudhës 2015 - 2021 duke pranuar rritjen e kohëve të fundit të çmimeve dhe kundërshtimit publik që ka shkaktuar ajo, si dhe trendin afatgjatë të mbajtjes së çmimeve të energjisë për konsumatorët shtëpiak nën kosto të sistemit. Shih gjithashtu, Gazeta Express "70 OJQ, me petitionin e qytetarëve kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike", shtator, 2014, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/70-ojq-bashke-me-qytetaret-peticionkunder-shtrenjtimit-te-energjisë-elektrike-44296/?archive=1>

Sistemi me futjen në funksion të TCKR-së është më i papërballueshëm. Futja në funksion e TCKR-së krijon vështirësi të veçantë për ata që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Futja në funksion e TCKR-së edhe për konsum modest mujor të energjisë elektrike e ngrit koston e energjisë elektrike dhe absorbon 39.7 për qind të të ardhurave në vitin 2021. Me ZRRE-në e brengosur për humbjet teknike dhe komerciale të energjisë elektrike dhe Bankën Botërore që sugjeron që të ndërmerren veprime më të ashpra ndaj lidhjeve të paligjshme në sistemin elektrik (shih Seksioni VI: *Rëndësia e rolit të Bankës Botërore në zhvillimin e Termocentralit Kosova e Re*), futja në funksion e TCKR-së duket se ofron stimuj më të fortë për më shumë klasa të familjeve që të përpiqen dhe të lidhen jashtë matësit të rrymës ose të gjejnë forma të tjera të shfrytëzimit të paligjshëm të energjisë elektrike.